



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Ndihma e huaj në Shqipëri



Raporti
i Progresit
2008



Departamenti i Bashkërendimit
të Strategjive dhe Koordinimit
të Ndhmës së Huaj

Tetor 2009



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Ndihma e huaj në Shqipëri

Raporti i Progresit 2008

**Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe
Koordinimit të Ndhmës së Huaj**

Tetor 2009

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
PARATHËNIE E DEBASKON-IT	6
PËRBËRJA E NDIHMËS SË HUAJ	8
Sipas llojeve	8
Sipas donatorëve	9
Sipas sektorëve	12
Sipas statusit	13
INVESTIMET PUBLIKE ME FINANCIM TË BRENDSHËM DHE TË HUAJ	13
PËRSHKRIM SEKTORIAL 2000-2008	15
DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS	16
DREJTËSIA DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME	20
EKONOMIA E TREGUT	27
INFRASTRUKTURA	33
ZHVILLIMI SOCIAL	39
ZHVILLIMI URBAN, RURAL DHE RAJONAL	46
DIALOGU I POLITIKAVE QEVERI-DONATORË	50
PLANI I VEPRIMIT PËR HARMONIZIM	51
SHTOJCA 1. GSP DHE KALENDARI I TAKIMEVE	52

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BEI	Banka Europiane e Investimeve
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CARDS	Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës
DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim
DfID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
EURALIUS	Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GSP	Grupet Sektoriale të Punës
GEF	Shërbim i Mjedisit Global
GRECO	Këshilli i Europës Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
GTZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunimin Teknik
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFN	Institetet Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPA	Instrumenti i Para-aderimit
IPARD	IPA për Zhvillimin Rural
KE	Komisioni European
LCDP	Programi i Zhvillimit të Komuniteteve Lokale
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MFP	Menaxhimi i Financimeve Publike
MIPD	Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NATO	Aleanca e Atlantikut të Veriut
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
ODA	Ndihma Zyrtare e Zhvillimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OECD/DAC	Komiteti i OECD për Zhvillimin e Ndhmës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PAMECA	Misioni i Asistencës së Policisë i Komunitetit European për Shqipërinë
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto

PBP	Përfaqse me Bazë Programi
PBS	Përfaqse me Bazë Sektori
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare
PEIR	Rishikimi i Shpenzimeve Publike dhe Institucionale
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PPR	Programi i Rishikimit të Politikës
PVH	Plani i Veprimit për Harmonizimin
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SPPS	Mbështetje për Sistemet e Prokurimit Publik
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV/SIDA
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komisioni i Nivelit të Lartë për Refugjatët për Kombet e Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët nga Kombet e Bashkuara
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Industrinë dhe Zhvillimin
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Ministri, Departamente dhe Agjensi e Njësi të tjera qeveritare

CFCU	Njësia Qendrore Financiare e Kontraktimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
INSTAT	Instituti i Statistikave
KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KM	Këshilli i Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MADA	Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MB	Ministria e Brendshme
METE	Ministrie e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
ITAP	Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike

PARATHËNIE E DEBASKON-IT

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) në emër të Qeverisë së Shqipërisë, me objektiv kyç forcimin e rolit të Qeverisë në bashkërendimin e ndihmës së huaj. Raporti synon të japë një tablo analitike të aktiviteteve donatore në Shqipëri dhe të pasqyrojë mbështetjen e donatorëve sipas sektorëve të ndryshëm.

Raporti është përgatitur në kuadrin e përpjekjeve të vazhdueshme të përbashkëta për të përmirësuar bashkërendimin dhe efikasitetin e ndihmës së huaj si dhe për të sinkronizuar punën e agjencive donatore dhe qeveritare në Shqipëri. Nisur nga intensifikimi në vitet e fundit i çështjeve të menaxhimit të ndihmës së huaj, Qeveria shqiptare synon të ndjekë fuqimisht një qasje më dinamike në lidhje me ndihmën e huaj, në përgjigje të rritjes së shkallës së pjekurisë dhe përmirësimit të proceseve të planifikimit strategjik dhe të monitorimit. Është rritur ndërgjegjësimi në nivel global, që bashkërendimi i donatorëve është i lidhur ngushtë me përdorimin në mënyrë sa më të efektshëm të ndihmës, siç parashtrohet edhe në Deklaratën e Parisit për Efikasitetin e Ndhimave.

Në kontekstin shqiptar, ky ndërgjegjësim thellohet në një realitet ku ndihma zyrtare për zhvillim (NZZH - ODA) e bazuar në grante sa vjen e po pakësohet, dhe rrjedhimisht, agjencitë dhe qeveria duhet të bashkëpunojnë më ngushtë për të rritur efektivitetin e kontributeve të tyre. Zhvillimi ekonomik afatgjatë i qëndrueshëm dhe i balancuar, si dhe integrimi i ekonomisë shqiptare në BE, sjellin nevojën e maksimizimit të efikasitetit të fondeve të brendshme dhe të jashtme të investimit. Bazuar në parimin e Deklaratës së Parisit, si Qeveria ashtu edhe donatorët po synojnë që institucionet kombëtare të vënë nën zotërim proceset zhvilluese, harmonizimin me strategjitë kombëtare për zhvillim, dhe sinkronizimin e bashkëpunimit me donatorët.

Rrjedhimisht, vitet e fundit është krijuar një bazë e mirë për krijimin e strukturave bashkërenduese për ndihmën e huaj, dhe Qeveria me donatorët kanë vendosur, bashkërisht dhe individualisht, mekanizma për rritjen e bashkërendimit dhe efikasitetit.

Në aspektin institucional, krijimi i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON), i Sekretariatit Teknik të Donatorëve dhe i një sërë organesh bashkërenduese dhe këshilluese¹, synon ta bëjë më të qartë punën e agjencive donatore, të përmirësojë shkëmbimin e informacionit dhe të shërbejë si bazë për bashkërendime të mëtejshme.

Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, me rol kryesor zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), është mandatuar që të garantojë rolin aktiv të Qeverisë në bashkërendimin me efikasitet të ndihmës së huaj. DEBASKON-i bashkëdrejton me Ministrinë e Financave negociatat me donatorët në përcaktimin e kushteve të politikave për rastet e huave/kredive, dhe merr pjesë në negociatat për programimin e IPA-s, të drejtuara nga Ministria e Integritit.

Procesi i bashkërendimit të ndihmës së huaj në vetvete, bazohet në një sërë procesesh kyçe të Qeverisë, në kuadrin e SPI-së, siç janë programi i qeverisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA).

DEBASKON-i ka krijuar tashmë një bazë të dhënash të ndihmës së huaj, e cila përmban mbi 760 projekte në zbatim dhe të planifikuara. Kjo bazë të dhënash synon të japë një panoramë analitike

¹ Grupi Mbështetës i SPI-së, tryezat e rrumbullakëta Qeveri-Donatorë, Grupet Sektoriale të Punës.

të aktiviteteve të donatorëve në sektorë të ndryshëm².

Për të përmirësuar bashkërendimin dhe monitorimin në nivel sektori të ndihmës së huaj, janë ngritur 10 Grupe Sektoriale Pune dhe rreth 30 nëngrupe për shumicën e fushave dhe nënfushave.

Të paktën 28 takime të GSP-ve dhe nëngrupeve të tyre janë organizuar gjatë vitit 2008. Përmirësime të dukshme janë bërë në vitin 2009. Gjatë këtij viti në janar 2009 u hartua për herë të parë kalendar i takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës, i cili iu prezantua dhe komunitetit të donatorëve. Në bazë të këtij kalendar, GSP-të do të takoheshin të paktën një herë në tre muaj. Një kopje e ndarjes së GSP-ve dhe kalendarit të takimeve gjendet në Shtojcën 1.

Në vitin 2008, DEBASKON-i përgatiti Dokumentin e parë të Orientimit të Ndihmës së Huaj (DONH). Ky dokument fokusohet në rolin e ndihmës së huaj në zhvillimin e Shqipërisë, veçanërisht në prioritetet imediate dhe afatmesme që duhet të financohen nga ndihma e huaj gjatë periudhës 2008-2013 dhe që bazohen në SKZHI. Gjithashtu, DONH-i futi mënyra të reja për të rritur rolin dhe zotërimin e Qeverisë në menaxhimin e ndihmës së huaj.

Ky dokument synon të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e monitorimit të ndihmës së huaj, në kuadrin e zbatimit të SPI-së. Dokumenti përpiket të analizojë zbatimin e ndihmës së huaj si në nivel sektorial, ashtu edhe në nivel ndër-sektorial. Po aq i rëndësishëm është synimi i dokumentit për të ndihmuar procesin e buxhetimit, me qëllim që të arrihet bashkërendimi ndërmjet investimeve të brendshme dhe ndihmës së huaj. DEBASKON-i ka planifikuar ta përgatisë çdo vit këtë dokument monitorimi të ndihmës së huaj, për të kontribuar në këtë bashkërendim. Kjo do të shërbejë si incentivë e përvitshme për regjistrimin e ndihmës së huaj dhe për të garantuar cilësinë e informacionit që mund të përdoret nga donatorët.

METODOLOGJIA

Ky raport është përgatitur nga DEBASKON-i. Si burim parësor të dhënash ka shërbyer baza e të dhënave e donatorëve, e administruar nga DEBASKON-i, ndërsa burimet dytësore përfshijnë bazën e të dhënave të OECD/DAC, DONH, SKZHI dhe rezultatet e Anketimit 2008 për monitorimin e Deklaratës së Parisit.


Informacioni i bazës së të dhënave është siguruar drejtpërdrejt ose është vlerësuar me donatorët përkatës dhe ministritë e linjës përpara se të vazhdohej me analiza të mëtejshme; ky informacion tregon fondet e angazhuara dhe të lëvruara nga 1 janari 2008 deri më 31 dhjetor 2008. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për një bazë të dhënash të besueshme të ndihmës donatore, disa pasaktësi dhe mospërputhje janë të pashmangshme në këtë fazë. Analizimi i prirjeve të shkuara të ndihmës së huaj, është bërë si një proces i zakonshëm pune në DEBASKON, duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesit e Sekretariatit Teknik të Donatorëve.

Raportimi i sektorëve ndjek ndarjen sektoriale të SKZHI-së, që shërben gjithashtu si bazë për të monitoruar progresin e zbatimit të SKZHI-së. Të dhënat e paraqitura në grafikët dhe tabelat sektoriale, janë marrë kryesisht nga baza e të dhënave e DEBASKON-it të cilën komuniteti donator e përditëson dy herë në vit.

Kufizimet: DEBASKON-i është i vetëdijshëm që disa të dhëna mund të mos jenë plotësisht të sakta. Këto pasaktësi pasqyrohen edhe në pjesën rrëfyese për sektorët.

2 Duhet theksuar se të dhënat në bazat e të dhënave përpunohen me mënyrë manuale dhe se cilësia dhe formati i informacionit që vjen nga donatorët, është shpesh i dobët.

Prirjet e përgjithshme të Ndhimës së Huaj



Burimi: OECD/DAC për periudhën 2000-2005; baza e të dhënave të donatorëve e DEBASKON-it për 2006-2008.

Totali i ndihmës së huaj gjatë viteve 2000-2008 ka qenë rreth 2.93 miliard €, nga të cilat rreth 1.79 miliard € (rreth 61%) kanë qenë grante, 1.13 miliard € në hua (rreth 39%)³. Që në vitin 2000, nivelet e ndihmës së huaj kanë qëndruar në kufijtë e 250-380 milion € në vit. Figura 1.1 tregon shpërndarjen e ndihmës së huaj përgjatë kësaj periudhe kohore (2000-2008).

Krahasuar me shtetet e rajonit, Shqipëria ka marrë më pak ndihmë të jashtme për frymë (Tabela 1.1).

Që në vitin 2000, përqindja e ndihmës së huaj kundrejt prodhimit të brendshëm bruto (PBB), ka pësuar rënie. Kjo më tepër për shkak të rritjes së PBB-së (e cila është rritur në 8.7 milion Euro në vitin 2008 krahasuar me 4.6 milionë Euro në vitin 2001), sesa nga ulja e niveleve të ndihmës së huaj. Në vitin 2008, përqindja e ndihmës së huaj kundrejt PBB-së, ishte 3.65%.

Tabela 1.1 Ndhima e Huaj (€) për frymë në vit, mesatarisht 2000-2008

	Ndhima e Huaj për frymë (€)	Popullsia (milionë)
Shqipëria	100	3.2
Bosnje-Hercegovina	144	3.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	114	2
Serbia	164	7.4

Burimi: OECD/DAC (2008) dhe World Development Indicators (WDI) (2008)

Përbërja e ndihmës së huaj⁴

SIPAS LLOJEVE

Gjatë periudhës 2000-2008 ndihma e huaj është ofruar në formë granti dypalësh, huaje shumëpalëshe, granti shumëpalësh, hua jo-koncesionare dhe hua dypalëshe (Figura 1.2). Në vitin 2000 grantet përbënin 68% të angazhimit të ndihmës së huaj, ndërsa vitet që pasuan ky lloj financimi është ulur ndjeshëm. Grantet dypalëshe u pakësuan katër vitet e fundit dhe pritet të pakësohen më tej, pasi disa donatorë dypalësh po largohen gradualisht. Shumica e huave dhënë nga donatorët shumëpalësh është e orientuar drejt sektorëve të infrastrukturës, energjisë, shëndetësisë, arsimit dhe reformave sociale. Rritja e nivelit të huave dhe transformimi i huave të buta (me terma koncesionare) në hua komerciale, lidhet edhe me kalimin e Shqipërisë nga vend me të ardhura të ulëta në vend me të ardhura të mesme. Nga ana tjetër, po rritet numri i huave jo-koncesionare, për shkak se Shqipëria kaloi nga vend i Organizatës Kombëtare për Zhvillim (IDA),

³ Burimi: OECD/DAC për periudhën 2000-2005; baza e të dhënave të donatorëve e DEBASKON-it për 2006-2008.


⁴ Të dhënat për këtë seksion janë marrë nga baza e të dhënave të donatorëve e cila nuk përputhet plotësisht me bazën e të dhënave të OECD/DAC.

në një vend të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Ndarja e ndihmës së huaj në grante dhe hua për periudhën 2000-2008 nga donatorë dy dhe shumëpalësh jepet në Figurën 1.2. Nga grafikët duket qartë që pjesa më e madhe e ndihmës së ofruar nga donatorët shumëpalësh është në formën e huave, kurse ajo e ofruar nga donatorët dypalësh është në formën e granteve.

BERZH-i vazhdon të jetë burimi kryesor i huave tregëtare, me një portofol prej rreth 195.6 milion €, kryesisht në energjetikë dhe transport. Totali i projekteve të miratuara të BEI-t është rreth 268.5 milion € që mbulojnë energjetikën dhe transportin, por përfshijnë edhe ujësjellës-kanalizimet dhe së fundmi, edhe arsimin. Banka e Këshillit të Europës ka miratuar projekte me vlerë rreth 74 milion €, të cilat mbështesin shëndetësinë, arsimin dhe strehimin social⁵. Ndihma e siguruar prej këtyre bankave cilësohet e çmuar për qeverinë, për shkak të aftësisë për të mbështetur investimet me afat të gjatë dhe për bashkëpunimin që ato kanë me donatorë dypalësh dhe shumëpalësh, me banka të tjera tregtare dhe me sektorin privat.

Figura 1.2 Grantet dhe Huatë Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2000-2008 (milionë €)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

SIPAS DONATORËVE

Në Shqipëri operojnë 11 donatorë shumëpalësh, (asistenca e të cilëve përbën rreth 58% të ndihmës së huaj) dhe 23 donatorë dypalësh. Dy donatorët më të mëdhenj shumëpalësh gjatë periudhës 2000-2008 kanë qenë Komisioni European (mbi 465 milion €) dhe Banka Botërore (mbi 277 milion Euro kryesisht në formë huaje), që së bashku përbëjnë 32% të ndihmës së huaj. Ndër donatorët dypalësh, pesë më kryesorët janë Italia (hua dhe grante mbi 288 milion €), Gjermania (hua dhe grante mbi 141 milion €), Japonia (mbi 88 milion €), SHBA (grante mbi 81 milion €) dhe Holanda (grante mbi 79 milion €) që së bashku përbëjnë pak më shumë se 29% të totalit të ndihmës së huaj për periudhën 2000-2008.

Figura 1.3 Ndihma e huaj e angazhuar sipas donatorëve, 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 3% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

5 Shifrat janë marrë nga baza e të dhënave të donatorëve për periudhën 2000-2008.


Figura 1.4 Ndhimja e Huaj (disbursimet) sipas donatorëve, 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 3% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

Figura 1.5 Angazhimet dhe disbursimet nga donatorë dy dhe shumëpalësh 2000-2008 (në milionë Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Donatorët Shumëpalësh

Komisioni European. Gjatë periudhës 1991-2007, ndihma e dhënë nga Komisioni European llogaritet me rreth 1.3 miliardë euro. Rreth 635 milionë Euro janë dhënë nëpërmjet programit Phare gjatë viteve 1991 deri në 2000. Kurse nga viti 2001 deri 2006 Shqipëria përfitoi rreth 330 milionë Euro nga programi CARDS. Kjo ndihmë konsistonte në katër prioritete të mëdha: drejtësia dhe çështjet e brendshme (rreth 40% e fondeve), ngritje kapacitetesh administrative (rreth 20%), zhvillim ekonomik dhe social (rreth 35%), dhe demokraci të qëndrueshme (rreth 5%).

Që nga viti 2007, Fondet e Instrumentit të Para-aderimit mbështesin Shqipërinë si vend kandidat potencial duke zëvendësuar programin e mëparshëm CARDS. Shqipëria ka përfitur nga dy prej 5 komponentëve të IPA-s, dhe konkretisht nga Komponent I – Ndhimja për Tranzicionin dhe Ngritjen e Institucioneve dhe Komponenti II – Bashkëpunimi Ndërkufitar. Objektivi i IPA-s është të sigurojë një menaxhim të

plotë të decentralizuar. Shumat e alokuara për Shqipërinë në Kuadrin Financiar Shumëvjeçar (MIF) 2008-2010 llogariten në 245.1 milionë Euro. Disa nga fushat ku ka kontribuar Komisioni European sipas komponentëve të IPA-s janë (i) forcimi i institucioneve demokratike dhe shtetit të së drejtës; (ii) mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut; (iii) reforma e administratës publike; (iv) reforma në drejtësi dhe në çështjet e brendshme; (v) mbështetje ndaj reformave ekonomike nëpërmjet ndihmës së sektorit privat, ristrukturimit të industrisë dhe modernizimit të sektorëve strategjikë; (vi) politika të mbrojtjes së mjedisit; (vii) zhvillimi i shoqërisë civile dhe përfshirja sociale etj.

Banka Botërore. Programi i ndihmës i Bankës Botërore ka patur si synim reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e standardeve të jetesës, krijimit të vendeve të reja të punës, përgjegjshmërinë e qeverisë, infrastrukturën dhe shërbimet sociale. Që nga fillimi i angazhimit të Bankës Botërore në Shqipëri nga Bordi i Drejtorëve janë miratuar 67 projekte me një shumë totale 997.5 milionë

dollarë. Në vitin 2008, si rrjedhojë e arritjeve të dukshme dhe rritjes ekonomike, Shqipëria ka arritur statusin e vendit me të ardhura të mesme dhe si e tillë nuk përfiton më nga financimet me zero interes të IDA-s (International Development Assistance), hua këto të aplikueshme për vendet e varfra, por kualifikohet për hua tregtare nga IBRD (International Bank for Reconstruction and Development), duke dërguar sinjale pozitive për investitorët dhe tregjet financiare për të ardhmen ekonomike të vendit. Shqipëria konsiderohet e besueshme dhe e aftë për hua tregtare. Ndër sektorët që po përfitojnë nga ndihma e Bankës Botërore mund të përmenden (1) Transporti; (2) Sektori privat dhe financiar; (3) Ujësjellës Kanalizimet; (4) Bujqësia, Zhvillimi Rural dhe Mjedisi; (5) Qeverisja, Reforma Administrative dhe Antikorrupsioni; (5) Burimet njerëzore.

Donatorët dypalësh

Italia nëpërmjet Kooperacionit Italian ka qenë shumë aktive në Shqipëri që nga viti 1991 me një angazhim financiar prej rreth 650 milionë Euro. Italia është donatori i parë dypalësh dhe donator i tretë i madh pas Komisionit Europian dhe Bankës Botërore. Nëpërmjet fondeve që ka alokuar, Italia ka mbështetur zhvillimin dhe stabilitetin në vend, me synim demokratizimin dhe zhvillimin ekonomiko-social, forcimin juridik dhe institucional dhe integrimin në strukturat ndërkombëtare. Ndër projektet kryesore mund të përmendim: furnizimin me energji elektrike; ndërhyrje për rehabilitimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve për Tiranën, programet në sektorin e transportit të cilat synojnë përfundimin e akseve jug-veri (segmenti Shkodër - Hani Hotit) dhe ndërtimi i Korridorit VIII për Ballkanin (segmentin Lushnjë - Fier - Vlorë); mbështetje në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë; zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme nëpërmjet kreditimit, fondit të garancisë dhe asistencës teknike; mbështetje në sektorin e bujqësisë, (nëpërmjet programeve FAO, përmirësimin e sistemeve të kontrollit të ushqimit, rehabilitimin e stacioneve të kullimit në zonat me rrezik përmbetjeje, etj.); dhe mbështetje në fusha të tjera si mjedisi, kultura, institucionet, politikat sociale dhe trajnimi profesional.

Gjermania. Bashkëpunimi midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Shqipërisë filloi në vitin 1988. Objektivi kryesor i këtij bashkëpunimi, krahas atij të përmirësimit të kushteve të jetesës për qytetarët shqiptarë, është edhe mbështetja për t'u integruar në Bashkimin Europian. Zonat prioritare për të cilat është rënë dakord që në vitin 2001 janë: (1) Furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet dhe trajtimi i mbetjeve; (2) Energjia; (3) Zhvillim ekonomiko social i qëndrueshëm. Bashkëpunimi teknik dhe financiar realizohet nëpërmjet zyrave të GTZ-së dhe KfW-së në Tiranë.

Japonia. Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) është agjencia që ofron ndihmën e qeverisë japoneze në formën e bashkëpunimit teknik nëpërmjet granteve dhe huave. Ndër sektorët kryesorë që përfitojnë nga asistenca e Japonisë mund të përmendim: (i) mbështetje për zhvillimin e sektorit privat - në zhvillimin e burimeve njerëzore për promovimin e NVM-ve si dhe mbështetjen ndaj politikave për nxitjen e tregtisë dhe (ii) mbështetje për konsolidimin e paqes. Japonia ka dërguar konsulentë për formulimin e projekteve dhe ekupe studimore, dhe ka ofruar ndihmë në fushat e arsimit, bujqësisë, kujdesit shëndetësor duke i kushtuar vëmendje balancimit të përfitimit nga grupe të ndryshme etnike (iii) dhe gjithashtu mbështetje për zgjidhjen e problemeve mjedisore në rajon.

SHBA. Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) është një agjenci e pavarur që ofron ndihmë ekonomike, humanitare në mbarë botën në mbështetje të objektivave të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara. USAID-i ka operuar në Shqipëri që në vitin 1992. Gjatë kësaj kohe, USAID/Albania ka dhënë më shumë se \$414 milionë ndihmë për të mbështetur tranzicionin dhe zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe ka zbatuar programe në katër fusha: (i) Promovimi i Rritjes Ekonomike dhe Begatisë; (ii) Qeverisje e drejtë dhe demokratike; (iii) Investim në burime njerëzore; (iv) Realizimi i Paqes dhe Sigurisë. Programi i zhvillimit i USAID-it forcon transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë, reduktionin e korrupsionit, rritjen e konkurrencës në sektorin privat në Shqipëri, përmirëson shërbimin e kujdesit mjekësor, ndihmon në sigurimin e një rrjeti të qëndrueshëm dhe ekonomik të furnizimit me energji, dhe ul mundësinë e trafikimit të qenieve njerëzore. Faza e dytë e Programit Prag të Mijëveçarit (MCC) fokusohet në reformat në lidhje me luftën kundër korrupsionit në administratën publike dhe në sektorët e drejtësisë.

SIPAS SEKTORËVE

Mbështetja e akorduar sipas sektorëve ka pasur luhatje të mëdha nga viti në vit dhe për periudhën 2000-2008 kanë munguar prirjet e qarta. Megjithatë bazuar në analizat dhe vlerësimet e kryera, ndihma e huaj është alokuar në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentat strategjike për zhvillimin e vendit.

Tabela 1.2 Ndhimja e huaj sipas sektorëve, 2000-2008 (milionë EUR)

Sektori	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Total 200-2008	%
Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	85	61	49	67	64	89	36	41	31	523	18%
Zhvillimi ekonomik	30	32	36	17	11	15	16	23	26	206	7%
Transporti	16	16	26	32	20	16	20	29	75	250	9%
Energjetika	33	51	83	61	94	88	107	107	33	657	23%
Uji	99	53	22	37	47	53	40	48	10	409	14%
Zhvillimi social	67	47	37	102	46	46	26	37	25	433	15%
Zhvillimi territorial	10	11	13	5	12	15	19	14	17	116	4%
Të tjera	38	47	59	15	17	28	19	14	25	262	9%
Totali	378	318	325	336	312	351	284	314	240	2858	100%


Shënim (1): në terminologjinë e DAC-it, 'Zhvillimi ekonomik' përfshin bujqësinë, industrinë, tregtinë, biznesin/sistemin bankar/financat dhe turizmin.

Shënim (2): Shifrat pasqyrojnë huatë tregtare, të cilat për 2006-2007 bazohen në bazën e të dhënave të Donatorëve dhe për 2000-2005 në totale të DAC-it, akorduar sektorëve sipas bazës së të dhënave të Donatorëve.

Shënim (3): Të dhënat sektoriale të DAC-it për 2001 nuk përputhen me të dhënat e DAC-it të analizuara sipas donatorëve. Kjo u zgjidh duke u shpërndarë sektorëve totalin e analizës së donatorëve sipas përqindjes mesatare që zinin në vitin 2000 dhe 2002.

Burimi: OECD/DAC (2007); Shifrat më të mira të QSH nga baza e të dhënave të Donatorëve 2006, 2007 dhe 2008.

Figura 1.6 Ndhimja e Huaj (angazhimet) sipas sektorëve 2000-2008 (Euro milionë)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009


Një pjesë e mirë e mbështetjes i është kushtuar qeverisjes, përfshi demokratizimin dhe shtetin e së drejtës. Zhvillimi ekonomik, përfshi bujqësinë, industrinë, tregtinë, biznesin/financat dhe turizmin, është zgjeruar shpejt dy vitet e fundit, që mund të shpjegohet me përqendrimin e

vëmendjes së mjaft donatorëve në këtë fushë. Sektorët socialë kanë qenë më shumë në fokus vitet e shkuara, por tani treguesit konfirmojnë se ndihma e huaj për sektorët socialë ka pësuar rënie në vitet e fundit.

Mbështetja për infrastrukturën ka qëndruar e pandryshueshme në total (përveç në 2001), por ka pasur luhate të mëdha mes transportit, energjetikës dhe ujërave. Rritjet e fundit në huatë tregëtare tregojnë se mbi 50% e ndihmës së huaj për infrastrukturën tashmë vjen nga huatë koncesionale, shumica e të cilave shkojnë për sektorin energjetik.

SIPAS STATUSIT

Baza e të dhënave të donatorëve përfshin projekte që janë në vazhdim apo të planifikuara dhe kanë fonde të siguruara. Aty përfshihen gjithashtu projektet e përfunduara dhe disa shënime mbi programimet e mundshme. Situata në 2000-2008, jepet nga grafiku më poshtë:



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009.

Shënim: Grafiku tregon se rreth 279 milionë Euro janë planifikuar nga donatorët për projektet e ardhshme. Kjo shifër e ulët rezulton pjesërisht nga informacioni jo përfundimtar që është dhënë nga donatorët rreth angazhimeve të tyre të pritshme në vitet e ardhshme.

INVESTIMET PUBLIKE ME FINANCIM TË BRENDSHËM DHE TË HUAJ

Tabela 1.3 tregon nivelet e ndihmës së huaj dhe investimet me financim të brendshëm në sektorë të ndryshëm, siç janë regjistruar në Departamentin e Thesarit⁶ të Ministrisë së Financës. Në vitin 2008, financimi i brendshëm përbënte 54% të investimeve publike.

Transporti (56%), Mjedisi (56%), Drejtësia (56%) dhe Zhvillimi ekonomik (54%) janë sektorët me përqindje më të lartë investimesh me financim të huaj sesa ato me financim të brendshëm. Në sektorë të tjerë dominon financimi i brendshëm. Duhet theksuar niveli i ulët i investimeve me financim të huaj në Arsim 11% dhe Shëndetësi (17%).

6 Thesari nuk regjistron të gjitha lëvrimet e ndihmës së huaj, ndaj nuk mund të japë shifrën e saktë të lëvrimëve donatore për një vit të caktuar. Por, meqë janë shifra zyrtare, janë përfshirë në këtë raport. Të dhënat për investimet e brendshme për çdo sektor, nuk përfshijnë kostot korrente apo operative.

Tabela 1.3 Investimet Publike sipas sektorit dhe burimit të financimit 2008

	Me financim të Brendshëm milion EUR	Me financim të Huaj milion EUR	Me financim të Jashtëm si përqindje e totalit (%)
Drejtësia	3.15	3.8	55%
Rendi publik	9.0	0.03*	3%*
Arsimi	38.4	4.6	11%
Shëndetësia	16.8	3.4	17%
Punësimi	2.0	2.6	57%
Energjetika	7.2	32.9	22%
Ujësjellës-kanalizime	25.8	22.8	47%
Transporti	215.8	271.5	56%
Zhvillimi ekonomik	1.1	1.3	54%
Bujqësia	8.1	7.9	49%
Mjedisi	1.8	2.3	56%
Të tjera	52.4	0.5	1%
Totali	381.6	356.7	48%

Shënim (1): Investimet me financim si të brendshëm edhe të huaj, janë marrë nga shifrat faktike buxhetore 2008 (MF); Duhet vënë re se disa projekte me financim të huaj (sidomos grantet) u morën me vështirësi nga sistemi i Thesarit dhe në fakt shifra e investimeve me financim të huaj është më e lartë.

Shënim (2): Vlera e financuar nga burime të brendshme për Energjetikën nuk përfshin investimet për Korporatën Energjetike (KESH), për shkak se buxheti nuk financon investimet e KESH-it.

Burimi: Qeveria e Shqipërisë, Thesari dhe Buxheti 2008 (MF).

* Të dhënat për Rendin Publik janë marrë nga baza e të dhënave e Donatorëve.

Nevoja për përqendrim relativisht të lartë të mbështetjes së huaj në sektorët e mësipërm do të vazhdojë edhe për disa vite. Disa sektorë përfitojnë shumë ndihmë të huaj sepse përveç investimeve, kanë nevojë për asistencë teknike të fuqishme. Megjithatë, do të ketë një prirje për ngushtimin e diferencimeve ndërmjet sektorëve. Gjithashtu, disa nga huatë gjysmë-tregtare, kryesisht në energjetikë, do të bëhen plotësisht tregtare, nisur nga kalimi i Shqipërisë në vend që nuk mund të përfitojë më nga huatë me interes zero të IDA-s si dhe përdorimit më të gjerë të huave si mjete financiare nga bilateralët.

PËRSHKRIM SEKTORIAL 2000-2008


REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE FORCIMI I KAPACITETEVE

Krijimi i një administrate të mirëkualifikuar dhe profesioniste është në fokusin e prioriteteve të politikave të qeverisë. Në këtë aspekt, Progres Raporti 2008 i Komisionit Evropian njihet në këtë sektor për 2007-2008 dhe nënvizon nevojën për forcimin e paanësisë së administratës publike, me qëllim avancimin drejt një shërbimi civil profesional, të pavarur dhe të bazuar në merita.

Mbështetja donatore për këtë sektor ka qenë mbi 46 milion € në periudhën 2000-2008, me normë totale lëvrimi rreth 74% (mbi 34 milion €). Ndihma përbëhet kryesisht nga grante (73%) nga të cilat pushteti vendor përfitoi mbi 21 milion €. Donatorët kryesorë që kanë mbështetur reformën në administratën publike në vitet e fundit kanë qenë Banka Botërore, KE, SHBA, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Italia, Gjermania, etj. (shih grafikën më poshtë për shumat përkatëse). Fushat kryesore të mbështetura me ndihmë janë: reforma në shërbimin civil; trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore; bashkërendimi dhe hartimi i politikave; përmirësimi i kapaciteteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); decentralizimi dhe forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim rritjen e autoritetit dhe autonomisë fiskale të pushtetit vendor; llogaridhënia e zyrtarëve qeveritarë, rinovimi i ambienteve të zyrave; etj.

Figura 1.8 Administrimi Publik

Angazhimet kundrejt Disbursimeve sipas Donatorëve për 2000-2008 në milionë Euro



Shënim: Donatorët me kontribut nën 100 000 EUR, nuk përfshihen në grafik (OSBE, Turqia e Kanadaja).

Në bazë të Deklaratës së Parisit, donatorët argumentojnë se kapacitetet e mangëta financiare të qeverisë janë shkak i mbajtjes së Njësive të Manaxhimit të Projekteve (PIU). Qeveria është përpjekur ta adresojë këtë problem duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe duke rritur kapacitetet e administratës publike për zbatimin e projekteve të donatorëve. Gjithashtu, lëvrimi aktual i donatorëve, bazuar në të dhënat e tyre, është përgjithësisht më i ulët sesa angazhimi i fondeve. Kjo mospërputhje ndryshon shumë nga një donator te tjetri dhe ndodh kryesisht për shkak të vonësave në zbatimin e programeve (të cilat mund të ndodhin për shkaqe që lidhen si me donatorët ashtu edhe me qeverinë).

Projekti më i madh i Bankës Botërore në këtë sektor është 'Operacionet e Zhvillimit të Politikave' (DPO) që mbështet aspektet kyçe të programit të Qeverisë me një hua prej 6.8 milionë Euro. Projekti i Bankës Botërore për reformën në Administratën Publike me vlerë 5.8 milionë Euro (i cili përfundoi në vitin 2006) ka qenë shumë rëndësishëm për tre çështje kryesore: menaxhimi i shpenzimeve publike, menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik, dhe koordinimi dhe hartimi i politikave. Totali i ndihmës së huaj akorduar Shqipërisë për reformën në administratën

publike dhe ngritjen e kapaciteteve, është 8.5 milionë EUR dhe fokusohet në ngritjen institucionale, forcimin e kapaciteteve administrative, reformën në shërbim civil dhe decentralizimin. Disa nga projektet që mund të përmenden këtu janë CARDS 2003- Mbështetje për Reformat e Shërbimit Civil, CARDS 2004-Mbështetje për Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike (ITAP) edhe CARDS 2005- Ngritja e kapaciteteve për Ministrinë e Integritimit.

Këto fusha janë mbështetur edhe nga mjaft donatorë të tjerë si US/USAID, PNUD, Suedi/SIDA, OBSH, Gjermani/KfW dhe Itali. Gjithashtu, DFID (e pasuar nga SIDA dhe Holanda) ka dhënë mbështetje të madhe në menaxhimin e shpenzimeve publike. Një *Fond Besimi* prej 7.19 milion USD (~5.8 milionë EUR) kontribut i shtatë donatorëve⁷ dhe i menaxhuar nga Banka Botërore, u krijua në 2008-ën (për t'u lëvruar deri në 2010) për të mbështetur zbatimin e komponentëve të ndryshëm të Sistemit të Planifikimit të Integruar, me fokus forcimin e kapaciteteve për bashkërendimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive, menaxhimin e shpenzimeve dhe bashkërendimin e ndihmës.

Për sa i përket zbatimit, shqetësuese gjatë vitit 2008 kanë qenë vonesat në përgatitjen dhe fillimin e ekzekutimit të *Fondit Shumëpalësh të Besimit* të menaxhuar nga Banka Botërore në mbështetje të zbatimit të SPI-së.

Pavarësisht nga shqetësimet e përmendura më lart, mund të thuhet se mbështetja e huaj për reformën në administratën publike ka qenë e efektshme. Miratimi i projekt-strategjisë gjithëpërfshirëse për reformën në administratën publike do të shtrojë themelet për forcimin e mëtejshëm të administratës publike që të arrijë standardet e Integritimit Evropian si dhe të prioritetizojë më mirë ndihmën e huaj në të ardhmen. Hyrja në fuqi e MSA-së dhe ndjekja intensive e planit për zbatimin e saj, kërkojnë harmonizim më të mirë të ndihmës me nevojën për forcimin e kapaciteteve qendrore dhe vendore, me qëllim që të ngrihet një administratë e pavarur dhe e bazuar në merita. Përfundimi i përbashkët i disa raporteve vlerësuese është se ndihma e huaj duhet të përdorë më tepër ekspertizën vendase për dhënien e ndihmës; veçanërisht mosangazhimi më i madh i ITAP-it në ofrimin e trajnimeve, shihet si një mundësi e humbur. Strategjia ndërsektoriale për reformën në administratën publike parashikon ngritjen e Shkollës së Administratës Publike në fund të vitit 2013.

Koordinimi në këtë sektor realizohet nëpërmjet grupit të administrimit publik që është pjesë e grupit sektorial të punës (GSP) për Reformën në Modernizimin e Qeverisë dhe Parlamentit.


Grupi Mbështetës i SPI-së (ose GMiSPI), është një strukturë e përbashkët Qeveri – Donatorë, i cili mblidhet kryesisht për të diskutuar ecurinë e zbatimit të SPI-së si dhe çështje të lidhura me Fondin e Besimit. Janë organizuar dy takime të këtij grupi gjatë vitit 2008. Dy takime të tjera të GMiSPI-së janë mbajtur gjatë vitit 2009, respektivisht në Janar dhe Maj 2009. Këto takime kanë bërë një përmbledhje të progresit dhe aktiviteteve të bëra në kuadrin e SPI-së gjatë vitit 2008 dhe gjysmës së parë të vitit 2009. 2008-a ishte viti i parë në të cilin u zbatua në mënyrë të përpiktë kohore kalendarit i SPI-së në të gjithë ciklin e tij.

Prioritetet e ardhshme në funksion të reformës në administratën publike duhet të fokusohen në trajnimin e menjëhershëm të institucionalizuar dhe të përparësuar në mbështetje të forcimit të kapaciteteve të institucioneve shqiptare që merren me procesin e Integritimit Evropian dhe zbatimin e MSA-së në nivel qendror. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar thellimit të reformave të decentralizimit dhe forcimit të pushtetit vendor dhe rajonal. Një nga përparësitë më urgjente është forcimi i kapaciteteve të Departamentit të Administratës Publike (DAP) dhe ITAP-it si dhe ngritja e sistemit modern të menaxhimit të burimeve njerëzore. Me përparësi po ndiqet edhe dhënia e mbështetjes së mëtejshme për trajnimin e nëpunësve civilë në fushat e planifikimit strategjik dhe zbatimin e politikave zhvilluese.

⁷ Zbatimi i SPI-së mbështetet nga Fondi Shumëpalësh i Besimit ku kanë kontribuar këta donatorë: Mbretëria e Bashkuar nëpërmjet DfID (€ 2,21 milionë), Holanda (€ 1 milionë), Komisioni Evropian (€ 1 milionë), dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (500,000 Euro), qeveria e Suedisë nëpërmjet SIDA-s (430,000 Euros), Italia (272,000 Euro) and Zvicra (440,000 Euro).

Figura 1.9 Parlamenti, zgjedhjet, gjendja civile dhe kartat e identitetit

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas sektorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit elektorale që u adoptua me miratimin e të gjitha palëve, sistemi zgjedhor shqiptar ndryshoi nga i përzier në sistem proporcional rajonal. Përgatitjet për regjistrin elektronik të gjendjes civile dhe sistemin e adresave, përfunduan në nëntor 2008 dhe hodhën bazat për nxjerrjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike.

Ndihma donatore për këto tri fusha në periudhën 2000-2008 ka qenë rreth 7.6 milion EUR, me normë lëvrimi 50%. Parlamenti ka përfituar rreth 2 milion EUR, kryesisht nga Holanda (zbatuar nga OSBE-ja), të përqendruara në trajnime, përfshi krijimin e kapaciteteve të përhershme trajnuese brenda parlamentit, si dhe në forcimin e mbështetjes këshilluese, veçanërisht për Integrimin Euro-Atlantik.

Zgjedhjet përfituan më pak ndihmë, një total prej 460,000 € për periudhën raportuese. Holanda, Komisioni Europian dhe Mbretëria e Bashkuar kanë kontribuar me asistencë teknike në këtë fushë.

OSBE ka qenë shumë aktive në sektor me zbatimin e

projekteve të donatorëve të sipërpërmendur, por edhe me disa fonde shumë të vogla. Nga të tri fushat, regjistri i gjendjes civile dhe dokumentet e identifikimit kanë marrë pjesën më të madhe të ndihmës, mbi 5 milion € në total. KE-ja (një projekt zbatuar nga OSBE-ja) dhe Norvegjia janë donatorët që kontribuuan për regjistrin e gjendjes civile dhe dokumentet e identitetit, duke ofruar asistencë teknike për miratimin e procedurave dhe udhëzimeve të nevojshme për krijimin e një sistemi unik adresash në Shqipëri dhe për trajnimin e stafit të institucioneve përkatëse që do të bënin hedhjen e sistemit të ri të adresave në regjistrin e gjendjes civile. Pjesa më e madhe e lëvrimëve në këtë sektor është realizuar gjatë vitit 2008.

OSBE është pika fokale e GSP-së mbi zgjedhjet dhe regjistrin e gjendjes civile. Mjaft takime të këtij grupi janë mbajtur gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 (për shkak të afrimit të fushatës zgjedhore) për të diskutuar kontributet e donatorëve të ndryshëm në reformën elektorale dhe shmangien e mbivendosjes së ndihmës së tyre.

Prioritetet e ardhshme për mbështetje nga donatorët në këtë sektor duhet të fokusohen në përmirësimin e rolit të Parlamentit në monitorimin e zbatimit të detyrimeve të MSA-së, trajnimin e stafit parlamentar në lidhje me legjislativën e BE-së dhe përmirësimin e përgjithshëm legjislativ në secilin nënsektor.

MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE


Në tetor 2007, Qeveria miratoi për herë të parë Fondin për Shoqërinë Civile me një buxhet total prej 1.3 milion €, me synim mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri. Qeveria, në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile, do të institucionalizojë Fondin e Shoqërisë Civile, me qëllim që ta bëjë atë të përhershëm. Parlamenti miratoi ligjin që institucionalizon ngritjen e Agjencisë së Shoqërisë Civile nën Këshillin e Ministrave, si struktura përgjegjëse për administrimin e Fondit. Janë miratuar gjithashtu aktet nënligjore për ta bërë Agjencinë funksionale.

Angazhimi donator në total për këtë sektor është rreth 20 milion € gjatë periudhës raportuese, me normë lëvrimi rreth 58%. Donatori kryesor në këtë sektor është SHBA-ja, e ndjekur nga KE-ja, Gjermania, Suedia, Holanda. Shumë nga projektet janë zbatuar nga OSBE-ja.

Ato që kanë përfituar ndihmë të huaj në këtë sektor janë: organizatat e shoqërisë civile dhe Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT). Ndihmë kanë marrë edhe shoqatat e mediave apo organe të ngjashme.

Figura 1.10 Media dhe Shoqëria civile

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve në 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Në këtë grafik janë përfshirë vetëm donatorët më të mëdhenj. Kontribute më të vogla janë dhënë edhe nga Austria, Mbretëria e Bashkuar, Turqia dhe Kanadaja.

Ato që kanë përfituar ndihmë të huaj në këtë sektor janë: organizatat e shoqërisë civile dhe Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT). Ndihmë kanë marrë edhe shoqatat e mediave apo organe të ngjashme.

Aktorët kryesorë dypalësh që mbështesin këtë sektor janë Qeveria e SHBA-së, KE-ja, Gjermania, Suedia, Holanda dhe OSBE-ja ku fokusi kryesor i ndihmës ka qenë institucionalizimi i angazhimit të Shoqërisë Civile në Shqipëri dhe forcimi i kapaciteteve, por edhe ofrimi i shërbimeve me rreth 14 milion EUR. Fondacioni për një Shoqëri të Hapur – SOROS ka ofruar gjithashtu mbështetje në këtë sektor. Konkretisht, Kanadaja ka kontribuar kryesisht në trajnimin e gazetarëve dhe USAID-i ka mbështetur forcimin e rolit të shoqërisë civile në reforma dhe në median hulumtuese, duke u fokusuar në lidhjen midis medias dhe aktiviteteve me interesa qytetare.

Programi CARDS 2005/2006 i Komisionit European kap vlerën mbi 2 milion EUR dhe përqendrohet sidomos në ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, dhe 800 mijë EUR i janë kushtuar konsolidimit dhe forcimit të politikës dhe kapaciteteve të medias si dhe përfshirjes së saj në debatin e politikave evropiane. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë nga CARDS-i dhe IPA, Shqipëria merr pjesë edhe në programet komunitare, si psh Programin e 7^{te} Kuadër për Kërkimin Shkencor. Shqipëria merr pjesë gjithashtu edhe në Programin Kuadër për Sipërmarrjen dhe Novacionin, pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në qershor 2008.

Shqetësimi kryesor në **zbatimin** e ndihmës në këtë sektor mbetet përfshirja e kufizuar e shoqërisë civile në proceset e reformave si dhe avokatinë publike. Një raport i fundit vlerësues i Komisionit të KE-së, dilte në përfundimin se mbështetja nëpërmjet CARDS-it për zhvillimin e shoqërisë civile ka qenë 'shumë e kufizuar në fushëveprim (dhe financim) dhe me shumë gjasa jo shumë e efektshme'⁸, pasi është fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve dhe jo në forcimin institucional të aktiviteteve të shoqërisë civile. I njëjti përfundim vlen pak a shumë për të gjitha ndihmat që i janë dhënë këtij sektori.

Prioritet e ardhshme parashikojnë mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OJF-ve, veçanërisht të atyre jashtë Tiranës. Për sa i përket medias, vazhdon të jetë prioritet rritja e kapaciteteve monitoruese dhe burimeve teknike të KKRT-së si dhe reforma e mëtejshme në media drejt depolitizimit të saj.

Forcimi i shoqërisë civile dhe përfshirja e saj në vendimmarrje mbeten objektiva për t'u arritur, me një financim prej rreth 2% të akordimeve totale për Komponentin I në kuadër të Dokumentit të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2009-2011⁹. 4 milion EUR janë caktuar për projektet që synojnë forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe të medias në procesin e integritimit evropian gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, për tre deri në katër vitet e ardhshme, Qeveria e Shteteve të Bashkuara do t'i kushtojë shoqërisë civile më tepër vëmendje.

8 Vlerësimi ad hoc i Programeve të CARDS-it në Shqipëri, Projekt-Raporti i Tretë, dhjetor 2008

9 Raporti i MIPD 2009-2011

DREJTËSIA


Reforma në drejtësi ka qenë në qendër të vëmendjes së qeverive të fundit në Shqipëri, që kanë synuar të garantojnë pavarësinë e institucioneve gjyqësore. Zhvillimet e fundit të reformës legjislativë në Ministrinë e Drejtësisë janë përqendruar në: përmirësimin e kuadrit ligjor në thuajse të gjitha fushat e sistemit të drejtësisë; përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të gjykatave; përmirësimin e procedurave si dhe në organizimin dhe funksionimin e operatorëve në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Janë marrë një sërë nismash ligjore për të përmirësuar funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, zyra të avokatisë dhe zyra të Avokatit të Shtetit, si dhe për të përmirësuar procedurat dhe reformimin e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Është përgatitur ligji për privatizimin e sistemit të përbarimit me qëllim përfundimtar të vendimeve të gjykatës civile. Pavarësisht këtyre nismave, është ende në proces miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të reformës gjyqësore për përfundimin e kuadrit ligjor dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e saj.

Për periudhën 2000-2008, ndihma e huaj për këtë sektor ka pasur 63 projekte (28 të përfunduara, 33 në vazhdim dhe 2 ende në fazën e planifikimit), me total fondesh të angazhuara 70.4 milion EUR. Nga ky total, rreth 46.9 EUR (ose 66.5%) janë lëvruar deri në fund të 2008-ës.

Donatorët kryesorë në këtë sektor janë: KE-ja (fillimisht me programet CARDS dhe më pas me IPA 2007/2008), SHBA-ja, Holanda, Gjermania, Spanja dhe Suedia (fondet përkatëse të angazhuara dhe lëvruara jepen në grafikun më poshtë). Nënsektorët kryesorë të mbështetur nga ndihma e huaj janë (i) reforma ligjore, (ii) sistemi i gjykatave (iii) infrastruktura e burgjeve dhe qendrat e paraburgimit, drejtësia për të miturit, dhe programet trajnuese për administratorët gjyqësorë. Investime nga burime të brendshme janë bërë gjithashtu për institucione të pavarura të sistemit gjyqësor, të cilat janë përshtatur me investime të niveleve të ngjashme nga donatorët.

Figura 1.11 Drejtësia dhe punët e brendshme

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Angazhimi më i madh i planifikuar për këtë sektor është një projekt prej 10 milion Euro i mbështetur nga IPA 2007 (zbatimi nuk ka filluar) i cili do të japë mbështetje për zbatimin e masterplanit të qendrave të paraburgimit në Fier dhe Elbasan. Një tjetër projekt i madh në këtë sektor është ai në kuadër të IPA 2008 që mbështet infrastrukturën e burgjeve me një fond prej 5.5 milion EUR. Nga të gjitha projektet nën zbatim, ia vlen të përmenden: ndihma teknike e EURALIUS-it për

modernizimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri; ndërtimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda në Tiranë nëpërmjet fondeve të CARDS 2003; ndërtimi i burgut të Fushë-Krujës me fonde të CARDS 2001; programi 'Shteti i së Drejtës në Shqipëri' me fonde të 2007-ës nga SHBA-ja, etj.

Prioritetet e ardhshme: Mbështetja e re donatore duhet të përqendrohet në përmirësimin e kapaciteteve të burgjeve dhe shërbimeve për të burgosurit, trajnimin e administratës së burgjeve, programet e trajnimit për gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave si dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave. Mbështetje shtesë kërkohet edhe për zbatimin e Masterplanit për Qendrat e Paraburgimit si dhe për Sistemet e Menaxhimit të Informacionit në burgje.


MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIJVE

Shqipëria po zbaton konceptin e ri të menaxhimit të integruar të kufijve dhe në vitin 2006 miratoi Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) dhe planin e saj të veprimit, të cilat janë plotësisht në përputhje me 'Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në Ballkanin Perëndimor' të KE-së. Zhvillimet e fundit ligjore dhe institucionale në këtë fushë janë: miratimi në janar 2008 i ligjit të ri për Ruajtjen dhe Kontrollin e Kufijve Shtetërorë si dhe krijimi i Departamentit Autonom të Policisë së Kufirit dhe Migracionit. Janë përmirësuar masat administrative dhe procedurat bazë, si dhe është rritur bashkëpunimi me agjencitë e tjera si dhe bashkëpunimi ndërkufitar rajonal. Janë arritur marrëveshje bashkëpunimi ndërkufitar për operacione, patrullime dhe pika kalimi të përbashkëta, si dhe janë ngritur pika kontakti në drejtoritë kufitare me vendet fqinje. Janë forcuar kapacitetet e Postave të Inspektimit Kufitar në sektorin e veterinarisë dhe fitosanitar, të mbështetur nga përmirësimi i legjislacionit, pajisjeve dhe trajnimeve.

Në periudhën 2000-2008, **totali i fondeve donatore të angazhuara** për këtë sektor ishte rreth 65.11 milion EUR (grante të gjitha), me normë lëvrimi prej 40% (rreth 26.32 milion €). Donatori kryesor në këtë sektor është KE-ja (me rreth 77% të të gjitha fondeve të angazhuara), e ndjekur nga SHBA-ja (me 13.4 milion), Suedia, UN (UNHCR), Greqia dhe Holanda (këto katër të fundit kanë kontribuar me nga 0.25-0.46 milionë Euro secila).

Figura 1.12 Menaxhimi i integruar i kufijve

Angazhimet kundrejt disbursimeve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Fushat që morën pjesën më të madhe të ndihmës janë: ndërtimi dhe rehabilitimi i pikave ndërkufitare, sistemet e Teknologjisë dhe Informacionit, pajisjet dhe trajnimet, pikat e kalimit kufitar dhe kontrolli i kufirit blu, forcimi i inspektimeve kufitare veterinarë e fitosanitare, si dhe një numër programesh të bashkëpunimit ndërkufitar me shumë përfitues.

Projekti i vetëm më i madh në këtë fushë është TIMS (sistem informacioni për zbatimin e ligjit), financuar nga SHBA-ja me një total mbi 8.7 milion EUR. Projekte të tjera të mëdha në këtë sektor

janë: projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e integruar të kufijve (mbi 4.6 milion € financuar nga SHBA); programet e bashkëpunimit ndërkufitar financuar nga CARDS 2004 dhe 2005 (pothuaj 10 milion € në total); përmirësimi i infrastrukturës për disa pika kufitare kontrolli nëpërmjet CARDS 2006 me një fond total prej 5.5 milion EUR.

Grupi i punës i MIK-ut mban takime periodike çdo 3-4 muaj që organizohen nga Konsorciumi Ndërkombëtar që mbulon Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme. Konsorciumi përbëhet nga përfaqësues të organizatave donatore ndërkombëtare që ofrojnë ndihmë për Qeverinë shqiptare në fushën e zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, si dhe nga përfaqësues të institucioneve shqiptare të zbatimit të ligjit. Pjesa më e madhe e punës praktike të Konsorciumit, kryhet nëpërmjet shtatë grupeve të punës të tij dhe grupi i punës i MIK-ut është një prej tyre.

Prioritetet e ardhshme përfshijnë veçanërisht përmirësimin e teknologjisë së informacionit dhe asetëve operacionale infrastrukturore në pikat e kalimit kufitar. Në vitin 2009, të gjitha pikat e kalimit kufitar do të jenë të lidhura në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit TIMS dhe të pajisura me logjistikën e duhur. Prioritete gjithashtu duhet të jenë ngritja e kapaciteteve nëpërmjet një sistemi trajnuar për agjencinë dhe ndërmjet agjencive, në lidhje me MIK-un; përmirësimi i menaxhimit dhe kontrollit të kufirit blu; bashkëpunimi ndërkombëtar, sidomos në funksion të nismës për liberalizimin e vizave dhe zbatimin e marrëveshjes FRONTEX e cila synon të luftojë emigracionin e paligjshëm dhe krimin ndërkufitar që lidhet me të; si dhe rritja e kontrollit dhe forcimi i sigurisë kufitare ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe Shqipërisë. Duhet investime shtesë për të përmirësuar infrastrukturën në pikat e kalimit kufitar, për lidhjen në mënyrë elektronike të të gjitha pikave të kalimit kufitar nëpërmjet sistemit TIMS, si dhe për pajisjen e tyre me logjistikën e nevojshme. IPA 2009 parashikon të vazhdojë mbështetjen për infrastrukturën e pikave të kalimit kufitar.

MIGRACIONI

Shqipëria vazhdon të ketë përqindje të lartë emigracioni (mbi 25% e popullsisë totale dhe mbi 35% e krahut aktiv të punës janë emigrantë). Qeveria po angazhohet me politika zhvilluese që synojnë thithjen e trurit dhe përdorimin e kapitalit që vjen nga migracioni për zhvillimin social-ekonomik të vendit. Meqë shumica e emigrantëve janë krahë aktiv pune, ndikimi i emigracionit në tregun e punës bëhet mjaft i ndjeshëm.

KE-ja është donatori kryesor që mbështet çështjet e migracionit në Shqipëri. **Totali i ndihmës së huaj** në këtë sektor është 9.2 milion EUR, me normë lëvrimi rreth 47% të totalit të fondeve të angazhuara deri në fund të 2008-ës. KE-ja (me 8.9 milion €), Italia (me rreth 141,000 €) dhe Holanda (me 89,000 €), janë tre donatorët që mbështesin këtë sektor, ndërsa IOM-i në Shqipëri shërben si organizatë zbatuese ndërqeveritare që drejton çështjet e emigracionit. IOM ka mbështetur hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Strategjisë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe ka lehtësuar hartimin e Projekt-Planit Kombëtar të Veprimt për Remitancat. IOM-i aktualisht angazhohet me ngritjen e kapaciteteve për çështjet e kthimit dhe riprimit, dhe me ndihma të drejtpërdrejta për ri-integrimin e emigrantëve të kthyer që kanë qenë viktima të trafikimit.

POLICIA, KRIMI I ORGANIZUAR, TERRORIZMI DHE TRAFIKIMI

Përmirësimi strukturor dhe performanca e përmirësuar e Policisë së Shtetit në vitet e fundit, kanë mbështetur progresin e vazhdueshëm në luftën kundër krimin të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit. Miratimi i strategjisë 7-vjeçare të Policisë së Shtetit dhe miratimi në 2008-ën i ligjit të ri për Policinë e Shtetit, kanë përmirësuar kuadrin ligjor dhe strategjik, me synimin për të ngritur një institucion demokratik policimi që i shërben komunitetit shpejt dhe me përgjegjësi dhe që e afron punën e Policisë së Shtetit më afër standardeve të BE-së. Sfida kyçe mbeten Policimi në Komunitet që do të transformonte policinë nga polici reaguese ndaj krimin, në polici parandaluese (dinamike).

Në korrik 2008 u miratua Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Luftën Kundër Krimin të Organizuar, Trafikimit dhe Terrorizmit, por mbetet për t'u zbatuar. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në 2008 ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme për përcaktimin


e përgjegjësive, me qëllim zvogëlimin e mbivendosijeve të mundshme gjatë hetimeve. Bashkëpunimi midis organizatave është përmirësuar në nivele të larta, por mbetet problematik në nivelet operacionale. Që në maj 2007, Shqipëria ka filluar zbatimin e marrëveshjes strategjike me Europol-in.

Kohët e fundit ka filluar të zbatohet dhe programi amerikan i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit. Një nga komponentët e tij përfshin edhe ngritjen e Njësisë të përbashkëta Investigative. Në vitin 2007 zyra e Prokurorit të Përgjithshëm bëri më shumë përpjekje për dënimin e krimeve të lidhura me korrupsionin dhe ato ekonomike duke krijuar një Njësi të Përbashkët Investigimi në Tiranë, me përbërjen e Ministrisë së Brendshme të Financës dhe Shërbimit Informativ Kombëtar . Ky komponent do të pasojë suksesin e ngritjes së njësisë së Tiranës duke e shtrirë këtë edhe në zona të tjera përtej kryeqytetit dhe duke ngritur njësi pranë Zyrave të Prokurorit të Përgjithshëm në Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë për të hetuar dhe ndëshkuar krime të lidhura me korrupsionin dhe krime ekonomike.

Për periudhën 2000-2008, totali i **fondeve donatore të angazhuara** për këtë sektor ka qenë rreth 64 milion EUR, me normë lëvrimi rreth 60% (afërsisht 38 milion €). Donatorët kryesorë që mbështesin këtë sektor janë KE-ja (nëpërmjet CARDS dhe IPA), SHBA-ja, Holanda, Austria, Gjermania, etj. Kategoria ‘tjetër’ në grafikun më poshtë përfshin Italinë, Norvegjinë, Irlandën, Greqinë, Suedinë, Danimarkën, OSBE-në dhe Kanadanë.

Figura 1.13 Policia, krimi i organizuar, terrorizmi dhe trafikimi

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve në 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Nënsëktorët kryesorë që përfitojnë mbështetje donatore janë rendi publik (rreth 39 milion €), trafikimi i qenieve njerëzore (rreth 16 milion €), krimi i organizuar (rreth 8.6 milion €), mbrojtja e dëshmitarëve (rreth 0.8 milion €) dhe terrorizmi (rreth 0.45 milion €).

Burimi kryesor i mbështetjes për Policinë e Shtetit është Komisioni Evropian, kryesisht përmes fazave të ndryshme të misionit PAMECA. Edhe pse programi i ndihmës PAMECA III mbulon nevojat e policisë për këshillim, ndihmë teknike dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, përmirësime ka pasur edhe në infrastrukturën dhe pajisjet logjistike për strukturat e Policisë së Shtetit. Hetimi i krimit ekonomik është gjithashtu një nga prioritetet me rëndësi madhore për Policinë e Shtetit. Nga donatorët dypalësh, SHBA-ja

Figura 1.14 Policia, krimi i organizuar, terrorizmi dhe trafikimi

Fondet e angazhuara sipas nënsëktorit gjatë 2000-2008 (%)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

është burimi kryesor. Donatorë të tjerë dypalësh ndihmuan kryesisht projekte në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në një rast me mbështetje të përbashkët (Aksioni Ndërkombëtar kundër Trafikimit të Fëmijëve). Ndihma e huaj në këtë sektor mbulon edhe forcimin e kapaciteteve operative të policisë rrugore dhe sigurinë rrugore; përmirësimin e logjistikës së policisë; përmirësimin e qendrave operative dhe të emergjencave; mbështetjen për infrastrukturën e Policisë së Shtetit dhe asetet operationale, si edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit; mbështetjen për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit DATACOM të komunikacionit. Lufta kundër Krimin të Organizuar, Terrorizmit dhe Trafikimit është mbështetur nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës për operacione të veçanta (TIMS, RMIS, Datacom, Memex), forcimit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe luftës ndaj të gjitha llojeve të trafikimit.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik bashkërendoi procesin e konsultimit që u finalizua me miratimin në korrik 2008 të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2008-2010. Gjithashtu u miratua Strategjia për mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit. Megjithatë, mbetet shumë për të bërë, sidomos për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Prioritetet e ardhshme për 2009 përfshijnë institucionalizimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera kombëtare të zbatimit të ligjit; forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të personelit policor nëpërmjet trajnimit dhe rritjes së etikës në punë; rritjen e mëtejshme të standardeve të policimit duke ndjekur qasje të orientuara drejt qytetarit dhe zgjidhjes së problemeve, ashtu si në vendet më të zhvilluara; ngritjen e kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në aktivitetin e policisë (TIMS, DATACOM, MEMEX, RMIS). Mesa duket, aktiviteti donator do të vazhdojë me këto ritme edhe në planin afatmesëm. Por do të duhen projekte për të mbështetur strukturat që merren me mbrojtjen e dëshmitarëve, për zbatimin e Strategjisë Kundër Krimin të Organizuar, Luftës Kundër Trafikimit dhe Terrorizmit, si edhe për përmirësime logjistike dhe teknike.

ANTI-KORRUPSIONI


Reformat e suksesshme të kohëve të fundit në modernizimin e një sërë shërbimesh publike, kanë rritur transparencën dhe kanë pakësuar mundësinë për korrupsion. Janë futur procedurat elektronike për tatimet, prokurimet publike, licencimin dhe regjistrimin e bizneseve dhe sistemi i ri dixhital për pranimet në universitete. Në nivel ligjor dhe institucional, miratimi në tetor 2008 i Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisje Transparente (2008-2013) dhe plani i saj i veprimit, do t'i mundësojë Qeverisë shqiptare një qasje strategjike, propozime për reformim më afatgjatë dhe të qëndrueshëm në këtë fushë. Të gjitha ministritë e linjës kanë raportuar në funksion të strategjisë dhe kanë përcaktuar

masa institucionale konkrete kundër korrupsionit për 2009-ën.

Ndihma e huaj në këtë sektor ka qenë e fokusuar në masat antikorrupsion në taksa dhe dogana, duke forcuar masat anti-korrupsion, duke ngritur kapacitete monitorimi për zbatimin e planit të veprimit anti-korrupsion. Për periudhën 2000-2008, 9 projekte donatorësh janë hartuar dhe zbatuar në këtë sektor. Megjithatë ka patur shumë projekte të tjera donatorësh me fokus jo të drejtpërdrejt, por që kanë një ose dy komponentë që luftojnë korrupsionin. Nga të gjithë projektet e raportuar në këtë sektor, 5 prej tyre kanë përfunduar, 2 janë në vazhdim dhe 2 janë planifikuar dhe pritet të zbatohen. **Totali i shumës së angazhuar është afërsisht 22.2 milionë Euro (të gjitha grante), nga të cilat afërsisht 9.5 milionë Euro (ose 98% e shumës për projektet e përfunduara ose në**

Figura 1.15 Anti-korrupsioni

Angazhimet kundrejt disbursimeve për 2000-2008 (për të gjithë projektet e përfunduara ose në vazhdim) në mln Euro



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

vazhdim) u lëvruan deri në fund të vitit 2008. Pjesa tjetër e fondeve, shumë prej 12.7 milionë Euro u përket dy projekteve të planifikuara që do të financohen respektivisht nga SHBA nëpërmjet MCC dhe nga Komisioni European nëpërmjet IPA 2008. Donatori më i madh në sektor është SHBA-ja e ndjekur nga KE-ja, ndërsa Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja kanë financuar projekte më të vogla që jepen në grafikun e mëposhtëm në kategorinë “të tjerë”. Projekti më i madh në sektor është Programi Prag i Sfidës së Mijëvjeçarit, mbështetur nga SHBA-ja me një vlerë totale prej 20 milionë Euro i shtrirë në dy faza (faza e dytë pritet të përfundojë në vitin 2011).

Lloji i dytë i projekteve, të cilët përfshijnë komponentë antikorrupsion janë raportuar në sektorë të ndryshëm si atë të drejtësisë dhe punëve të brendshme (ku luftohet korrupsioni në gjykata), në fushën e taksave dhe doganave dhe në arsim. Ndër këto projekte mund të përmendim “Konsolidim i demokracisë duke nxitur organizatat jo qeveritare për mbrojtje agresive dhe për të presion për reforma antikorrupsion në sektorin publik”, “Asistencë ndaj institucioneve dhe organizatave juridike me qëllim forcimin e pavarësisë dhe kompetencave të pushtetit gjyqësor”, “Programi për të mundësuar bashkëpunimin ndërkufitar kundër korrupsionit”, etj. Këto lloj projektsh i shtojnë këtij sektori një shumë të angazhuar prej 5 milionë euro.

Prioritetet e ardhshme kryesore ku duhet të fokusohen politikat, janë zbatimi i Strategjisë Anti-korrupsion, përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me standardet e përcaktuara në konventat e Këshillit të Evropës kundër korrupsionit, pakësimi gradual i barrierave administrative, dhe marrja e masave shtrënguese, hetuese dhe ndëshkuese kundër rasteve të korrupsionit.

TË DREJTAT E PRONËS

Proceset kryesore mbi të cilat bazohet reforma e të drejtave të pronës janë regjistrimi, kthimi dhe kompensimi si dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje, të cilat janë vendimtare për funksionimin e tregut të tokës. Përpjekjet e tanishme janë përqendruar në regjistrimin fillestar të pasurive të patundshme në zonat urbane, në zonat prioritare turistike, infrastrukturë dhe rritjen demografike.

Gjatë 2000-2008, me të drejtat e pronës janë marrë tetë projekte donatore. Nga këto, 4 kanë përfunduar, 3 janë në proces dhe 1 është ende në fazën e planifikimit (ky mbështetet nga IPA). Totali i fondeve donatore të angazhuara në këtë periudhë është 5.4 milion EUR dhe deri në fund të 2008-ës është lëvruar rreth 24% e kësaj shume (1.3 milion €).


Projekti në zbatim i Bankës Botërore për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës, është projekti kryesor donator në këtë fushë. Ai adreson çështjen e regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe synon të përmirësojë shërbimin, efikasitetin dhe transparencën në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të përfundojë shumicën e regjistrimeve fillestare. Donatorë të tjerë që mbështesin këtë sektor janë KE-ja (2.4 milion €), Republika Çeke (1.7 milion €), Finlanda (0.6 milion €), SHBA-ja (0.3 milion €) dhe Gjermania (0.3 milion €).

Prioritetet kyçe të mbështetura nga donatorët përfshijnë: ndihmë për qeverinë për reformën e pronës; regjistrimin e pasurisë së paluajtshme; menaxhimin e ankimeve në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës.

Mbështetje shtesë do të japë një projekt i planifikuar në kuadrin e CARDS 2006, që pritet të fillojë shpejt dhe që synon shtrirjen në Zonat Bregdetare të shërbimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Figura 1.16 Anti-korrupsioni

Angazhimet e donatorëve për projektet në zbatim dhe ato të planifikuara 2000-2008 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Një nga prioritetet kyç mbetet dixhitalizimi i të dhënave të regjistrimit. Paralelisht, inventari i asetëve publike që do t'i transferohen njësisë të pushtetit vendor ka përfunduar në pjesën më të madhe, bashkë me transferimin e shumicës së pyjeve dhe kullotave, ndërsa në qarqe të caktuara ka filluar faza e dytë e transferimit të asetëve.

Koordinimi në sektorin e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme bëhet përmes GSP-së për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i njohur ndryshe si Konsortiumi Ndërkombëtar për të cilin SHBA (përmes ICITAP) është pika fokale për donatorët. Takimet e GSP-së organizohen në mbledhje të veçanta për çështje të ndryshme, si (i) reforma ligjore, përfshirë këtu drejtësinë për të miturit dhe reformën e burgjeve, (ii) mbrojtja e dëshmitarëve, (iii) policia dhe krimi i organizuar, (iv) menaxhimi i integruar i kufijve, (v) asistenca për trainimet dhe pajisjet. (vi) teknologjia dhe menaxhimi i informacionit. Gjatë vitit 2008 këto grupe të veçanta janë takuar rregullisht në çdo tre muaj. Përveç mbledhjeve të veçanta të këtyre grupeve, Konsortiumi Ndërkombëtar organizon një Mbledhje Plenare vjetore. Mbledhjet plenare të Konsortiumit Ndërkombëtar janë mbajtur në prill 2008 dhe prill 2009. Këto mbledhje plenare japin një përmbledhje të mbështetjes që BE, SHBA dhe një numër organizatash ndërkombëtare japin për policinë e shtetit dhe bëjnë një raport për qëndrueshmërinë dhe impaktin e trainimit të policisë, zbatimin e policimit në komunitet, veprimet e ndërmarra në luftimin me sukses të drogës dhe trafikimit, si dhe për sfidat e qëndrueshmërisë së teknologjisë së informacionit.

Ekonomia e tregut

FINANCAT PUBLIKE

Vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres në reformimin e sistemit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Ligji i ri për buxhetin i miratuar në 2008, ndihmoi në përmirësimin e funksionimit të institucioneve tatimore dhe buxhetore, si dhe në përshtatjen e ligjeve dhe praktikave të brendshme me standardet ndërkombëtare. Ministria e Financave, në kuadër të zbatimit të SPI-së, futi procedura moderne koherente për Planifikimin e Buxhetit Afatmesëm (PBA). Progres i mëtijshëm është bërë në konsolidimin e sistemit të kontrollit të brendshëm publik financiar, përfshi auditin e brendshëm, kontrollin dhe menaxhimin financiar, si dhe inspektimin financiar. Standardet e BE-së për Kontrollin e Brendshëm Publik Financiar janë në proces miratimi dhe zbatimi.


Strategjia sektoriale për Financat Publike miratuar në shkurt 2008 ka këto prioritet kryesore: (i) të përmirësojë cilësinë e shpenzimeve; (ii) të zgjerojë bazën e tatueshme dhe të harmonizojë politikatat tatimore me prioritetet kombëtare; (iii) të modernizojë menaxhimin e borxhit publik; (iv) dhe të rrisë performancën dhe besueshmërinë e organeve doganore dhe tatimore.

Shqipëria duhet të përmbushë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar të fondeve publike, të miratuara nga Shtetet Anëtare të BE-së. Një shembull i tillë është zhvillimi i Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar.

Totali i fondeve të angazhuara nga donatorët për këtë sektor është rreth 78.37 milion €, me normë lëvrimi 58.5% (rreth 45.9 milion €). Rreth 89% e kësaj ndihme janë grante (69.37 milion €) dhe 11.4% i ngelur i përket një huaje të vetme nga KE-ja (9 milion €).

Figura 1.17 Financat publike

Angazhimet kundrejt disburseve sipas donatorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Mbështetja donatore ka shkuar kryesisht për këto fusha: forcimi i menaxhimit të shpenzimeve publike; mbështetja e doganave nëpërmjet modernizimit të sistemeve të kontrollit dhe monitorimit doganor bazuar në standardet e BE-së; mbështetja për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor, mbështetja për prokurimin publik, për reformën në administratën tatimore, për sistemin bankar, nëpërmjet mbështetjes për përafrimin e Bankës së Shqipërisë (shih grafikun poshtë për kontributet përkatëse). Kategoria 'Të tjera' përfshin kryesisht ndihmën dhënë Ministrisë së Financave.

Figura 1.18 Financat publike

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas nënsektorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Aktivitetet e planifikuara do të vazhdojnë për doganat dhe tatimet; menaxhimin e financave publike vendore; zgjerimin e sistemit të Thesarit (nëpërmjet IPA 2008), mbështetjen për prokurimin publik, për përgatitjet e Bankës së Shqipërisë për përafrimin normal drejt Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe për të garantuar përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të Bankës me “*acquis communautaire*” dhe të praktikave të saj me standardet mbizotëruese të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Së fundmi, ka filluar puna për Sistemin e Zbatimit të Decentralizuar (SZD) në kuadrin e projektit ‘Përgatitja e autoriteteve shqiptare për Sistemin e Zbatimit të Decentralizuar të BE-së’. Objektivi i përgjithshëm është që të përgatiten autoritetet shqiptare siç duhet për të tërhequr ndihmën financiare të BE-së, duke ngritur struktura të kualifikuara dhe duke forcuar kapacitetet e institucioneve kyçe për menaxhimin teknik të programeve të decentralizuara, me qëllim që të garantohet menaxhimi i shëndoshë i SZD-së.

Bashkërendimi qeveri-donatorë në këtë sektor vazhdon prej vitesh nën drejtimin e Ministrisë së Financave. GSP është takuar duke u fokusuar në konsultimin e strategjisë së financave publike, konsultimin e ligjit të ri për menaxhimin e buxhetit, si dhe për diskutimin e politikave të pensioneve dhe sigurimeve shoqërore.

Prioritetet e ardhshme: Disa nga politikat kryesore që mund të kenë nevojë për **mbështetje të mëtejshme donatore** janë: (i) përmirësimi i standardeve të ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit dhe rritja e besueshmërisë së institucionit; (ii) forcimi i mëtejshëm i menaxhimit dhe kontrollit, (iii) si dhe i auditit të brendshëm brenda administratës tatimore me qëllim për të luftuar korrupsionin; (iv) përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore; (v) dhe përfundimi i dixhitalizimit të administratës tatimore (me Menaxhimin e Integruar të Sistemit – MIS).

ZHVILLIMI EKONOMIK

Në këto vite, financimet e brendshme janë përqendruar në programe për zhvillimin e NVM-ve dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve industriale, siç kërkon MSA-ja, si dhe për aktivitetet zhvilluese në sektorin minerar. Një program strategjik për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) 2007-2009 filloi të zbatohet nga qeveria shqiptare e cila alokoi dy fonde të ndryshme në ndihmë të eksportuesve shqiptarë (me vlerë prej 3 milionë dollarë në vit)

Disa privatizime të mëdha si ato të kompanive telefonike, ARMO-s, INSIG-ut dhe ekzekutimi i mjaft kontratave koncesionare, si psh. licensimi i kompanive të telefonisë celulare, kontratat


për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve me investime të brendshme ose të huaja kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) në vend.

Janë miratuar ligje të reja për prokurimin elektronik, pagimin *on-line* të tatimeve dhe regjistrimin *on-line* të bizneseve. Nismat të tjera ligjore si për shoqëritë tregtare, akreditimin, standardet dhe metrologjinë, pronësinë intelektuale, gjithashtu po përmirësojnë klimën e biznesit. Janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe që promovojnë bashkëpunimin ekonomik dhe investimet, me Republikën Çeke, Sllovakinë, Rusinë, Maltën, Bosnjë-Hercegovinën dhe Qipron, në kuadrin e bashkëpunimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së IHD-së.

Mbështetja donatore gjatë 2000-2008 ka qenë rreth 81.93 milion €, me normë lëvrimi 30.8% (pak mbi 25 milion € 25). Donatori kryesor është Italia, e ndjekur nga Spanja, KE, SHBA, Zvicra dhe BB. Grafiku ilustron fondet e angazhuara dhe lëvrimet për çdo donator. Nga ndihma totale prej 29 milion € janë grante dhe 52.8 milion € janë hua.

Figura 1.19 Zhvillimi ekonomik

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Nënspektori që ka përthithur shumicën e mbështetjes është ai i Ndërmarrjeve të Vogla të Mesme, i ndjekur nga tregtia dhe privatizimi (shih grafikun poshtë për shifrat përkatëse). Mbështetja donatore për këtë sektor është përqendruar në reformën e klimës së biznesit dhe forcimin institucional, promovimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve në tregjet e brendshme dhe të huaja, rritjen e aksesit në burimet financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme me qëllim zgjerimin dhe diversifikimin e biznesit, si dhe mbështetje për rregullimin dhe promovimin e tregtisë.

Disa nga zhvillimet kryesore gjatë vitit 2008 janë: (i) fillimi i programit për mbështetjen e NVM-ve, mbështetur nga Italia me vlerë 28 milionë Euro; (ii) programi i mbështetur nga KE/IPA 2007 për konkurrueshmërinë dhe novacionin e NVM-ve në shumën prej 5.8 milionë Euro; (iii) Fondi i Garancisë së Kredive për Tregtinë, njësia zbatuese e këtij Fondi është ngritur pranë Albinvest-it dhe nga 40 shoqëri private që kanë shprehur interes për Fondin, 17 kanë aplikuar për të përfituar; (iv) projekti i Bankës Botërore për Reformat në Fushën e Biznesit dhe Forcimi Institucional (BERIS) që çon drejt përmirësimit të kuadrit ligjor dhe procedurave për një klimë më të mirë biznesi në vend.

Figura 1.20 Zhvillimi ekonomik

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas nënsektorëve gjatë 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shqipëria është pjesë e programit të BE-së për novacionin dhe konkurrueshmërinë (CIP, me 3.6 miliard €) që promovon novacionin dhe zhvillimin e NVM-ve. Në kuadrin e Kartës Evropiane për NVM-të, Shqipëria do të ketë mundësinë të vendosë marrëdhënie të drejtpërdrejta me vendet e BE-së dhe të mësojë nga përvoja e tyre.

Prioritetet e ardhshme për ndihmën e huaj do të vazhdojnë të jenë: mbështetja për përmbylljen e reformës rregullatore që mundëson eliminimin e praktikave anti-konkurruese dhe rrit konkurrueshmërinë; (ii) promovimi i NVM-ve; (iii) promovimi i eksporteve dhe i investimeve të huaja të drejtpërdrejta; (iv) zbatimi i angazhimeve të MSA-së; (v) përfundimi i procesit të privatizimeve.

Mbështetja e mëtejshme për zhvillimin ekonomik në Shqipëri duhet të fokusohet në arritjen e standardeve, normave, direktivave dhe rregullave të BE-së, në funksion të zbatimit të MSA-së.


MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

Me miratimin e strategjisë ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut në 2008, pjesa më e madhe e përpjekjeve është orientuar drejt plotësimit të kuadrit ligjor. Një ligj i ri për “Mbrojtjen e Konsumatorit” një ligj për “Sigurinë e Përgjithshme, kërkesat themelore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore” u përfunduan dhe u miratuan. Progres është arritur në ngritjen e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit; në investimet për ngritjen e kapaciteteve; ngritjen e sistemit funksional për mbikëqyrjen e tregut, zhvillimin e sistemit të informacionit për ankesat e konsumatorëve dhe një sistemi të dhënash për rreziqet dhe aksidentet nga produktet; ngritjen e një rrjeti kombëtar qendrash për këshillimin e konsumatorëve, organizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe programeve edukative për mbrojtjen e konsumatorit, mbështetjen financiare për shoqatat e konsumatorëve si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara** për këtë fushë gjatë 2000-2008 është rreth 33.42 milion €, me normë totale lëvrimi 52.6% (17.6 milion €). Pjesa më e madhe e kësaj mbështetjeje është në grante (rreth 30 milion €), me një hua të vetme nga Banka Botërore (rreth 3.4 milion €). Donatori kryesor që mbështet këtë sektor është KE-ja me rreth 31% të financimeve. KE-ja ka dhënë mbështetje kryesisht për metrologjinë, standardet, certifikimin dhe akreditimin, sistemin e mbikëqyrjes së tregut dhe rregulloret teknike, si dhe për sigurinë ushqimore.

Brenda mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut, siguria ushqimore është nënfusha e vetme më e madhe që ka tërhequr rreth 71% të totalit të angazhuar.

Figura 1.21 Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut
Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Kontribute më të vogla janë dhënë edhe nga Republika Çeke dhe Kanadaja

Në 2008-ën çështjet për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut janë integruar dhe diskutuar në takimet e Grupit të Punës për Bujqësinë dhe Ushqimin, Zhvillimin Rural dhe Mbrojtjen e Konsumatorit (grup i cili është takuar respektivisht në janar, tetor dhe dhjetor 2008. Në 2009, sipas planit të GSP-ve është parashikuar të organizohen 3 takime të Grupit Sektorial të Punës.

Prioritetet e ardhshme përfshijnë mbështetjen për përfundimin e kuadrit ligjor, forcimin e kapaciteteve për sistemin modern të mbikëqyrjes së tregut dhe veçanërisht përmirësimin e infrastrukturës së laboratorëve dhe institucioneve bazë.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT


Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është prioriteti më i lartë i qeverisë shqiptare. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) u ngrit dhe u bë funksionale në 2008. Agjencia është përgjegjëse për caktimin e standardeve të TIK-ut dhe për çështjet e qeverisjes elektronike në përgjithësi. Në 2008 u adoptua dhe përmirësua kuadri ligjor për sistemet e informimit, kryesisht në komunikimin elektronik, telekomunikacione dhe shërbimet elektronike (shkollat elektronike dhe laboratorët). U përgatitën një sërë ligjesh të reja si mbrojtja e të dhënave personale, ligji për firmën elektronike, ligji për komunikimin elektronik. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013 u përfundua në konsultim me grupet e interesit dhe u miratua me vendin të Këshillit të Ministrave. Fushat e saj prioritare janë infrastruktura, qeverisja elektronike dhe shërbimet publike, arsimi dhe njohuritë, biznesi elektronik dhe kuadri ligjor.

Totali i fondeve donatore të angazhuara për këtë sektor është rreth 3.7 milion € (grante të gjitha) me normë lëvrimi 39.4% (rreth 1.5 milion €). Ky sektor është ndihmuar nga disa donatorë, nga të cilët kryesorët janë KE-ja, Italia dhe SHBA-ja. Grafiku më poshtë liston të gjithë donatorët me shumën përkatëse.

Donatorët po japin mbështetje kryesisht për të prodhuar një vlerësim metodik të gatishmërisë elektronike dhe ndarjen dixhitale në qytetet kryesore të Shqipërisë, për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes duke shpejtuar shkëmbimin e një game më të gjerë informacioni brenda qeverisë, duke rritur transparencën e administratës publike nëpërmjet TIK-ut, duke rritur aksesin publik në informacion (GovNET), duke dhënë ndihmë teknike dhe ngritje kapacitetesh për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, për Ministrinë e Financave etj. Gjithashtu, OKB-ja lehtësoi angazhimin e Akademisë estoneze të Qeverisjes Elektronike në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe për instalimin e sistemit Voice Over IP (VOIP) (komunikimit me zë nëpërmjet kompjuterit) në 14 ministri linje dhe në kryeministri. SHBA-ja financoi Programin e Sfidës së Mijëvjeçarit i zbatuar gjatë 2006-2008 (faza e parë), i cili ndihmoi në zvogëlimin e kohës që duhej për regjistrimin e biznesit. Në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, u instalua një sistem prokurimi elektronik dhe shërbime elektronike për pagimin e taksave. Faza e dytë ka filluar të zbatohet në 2009 deri në 2011 dhe do të kontribuojë më tej në mbështetjen e reformave të qeverisë në fushën e administratës tatimore duke ngritur Qendrën Kombëtare të Licencimit të Bizneseve, dhe sistemin e lejeve nëpërmjet një regjistri elektronik kombëtar për leje zhvillimi dhe ndërtimi, për kode planifikimi dhe ndërtimi dhe për udhëzime dhe shpallje.

Figura 1.22 TIK

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim 1: Ndihma e SHBA-së nuk tregohet në grafik, sepse programi MCC është raportuar tek sektori anti-korrupsion.

Shënim 2: Kontribute më të vogla janë dhënë edhe nga Kanadaja dhe Greqia

Prioritetet e ardhshme do të përfshijë mbështetje për AKSHI-n që të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet e qeverisjes elektronike, për integrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike për qytetarët, bizneset dhe institucionet qeveritare, për përmirësimin e kuadrit ligjor, organizimin strukturor dhe arkitekturën teknike e teknologjike, si edhe vlerësimin e kostove dhe afateve kohore për zbatimin e Syscord *Albania* apo të kuadrit ndëroperativ.

STATISTIKAT



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009.

Zbatimi i programit kombëtar 5-vjeçar për përmirësimin e Sistemit të Statistikave Kombëtare është vendimtar për INSTAT-in, pasi rrit transparencën e statistikave kombëtare dhe i sjell më afër kërkesave dhe standardeve të EUROSTAT-it. Në 2008, për herë të parë INSTAT-i publikoi shifrat e PBB-së tremujore. Hapa të mëtejshëm janë marrë në përgatitjet për hartimin e një plani strategjik afatgjatë për zhvillimin e llogarive kombëtare dhe statistikave rajonale.

Fondet donatore të angazhuara për këtë sektor janë rreth 12 milion € (grante të gjitha), me normë lëvrimi rreth 31.6% (3.8 milion €). Donatorët më aktivë në këtë sektor janë KE-ja, Suedia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, OKB-ja dhe Banka Botërore.

Në vitet e fundit, mbështetja donatore është përqendruar në ndihmën teknike për zhvillimin e Anketës për Buxhetin Familjar, zhvillimin e statistikave rajonale, demografike dhe sociale në Shqipëri, ndihmë në analizimin e statistikave ekonomike, si edhe në sigurimin e pajisjeve

kompjuterike (hardware) dhe programeve kompjuterike (software) për zyrat e INSTAT-it.

Mbledhja e të dhënave dhe analiza statistikore ka fituar ritëm gjatë vitit 2008. Janë kryer Anketa për Matjen e Nivelit të Jetesës (LSMS), Anketa Demografike dhe për Shëndetin dhe rezultatet e tyre do të dalin në gjysmën e parë të 2009-ës. Përgatitjet për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 janë në vazhdim. Qeveria është angazhuar të mbulojë të paktën 20% të kostos, ndërsa KE-ja do të financojë 8 milion Euro që do të lëvrohen në mesin e vitit 2010. Nisur nga kostoja e lartë e këtij projekti (buxheti total i llogaritur është rreth 17.5 milion €), INSTAT-i u ka kërkuar ndihmë financiare donatorëve të tjerë që janë aktivë në fushën e statistikave.

Takimi i parë i Grupit Sektorial të Punës për statistikën u mbajt në fillim të vitit 2009 dhe i kushtoi vëmendje të veçantë regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe mundësisë së tërheqjes së donatorëve të tjerë për të bashkëfinancuar këtë projekt.

Prioritetet e ardhshme përfshijnë: ndihmën donatore për regjistrimin e popullsisë në 2011; mbështetjen për realizimin e anketave të përvitshme për produktet; kapitalet fikse dhe mbetjet industriale; përpilimin e sekuencës së plotë të llogarisë kombëtare jofinanciare sipas sektorit institucional; të dhënat statistikore për zonat e vogla të gjeokoduara; anketimi për kostot e punës në ndërmarrjet jobujqësore. Më shumë donatorë mund të kontribuojnë në regjistrimin e popullsisë, i cili është një projekt kyç. Përveç regjistrimit të popullsisë në 2011-ën, ndihma e ardhshme duhet të synojë decentralizimin statistikor dhe fiskal nëpërmjet forcimit të rrjetit të zyrave rajonale të INSTAT-it dhe përafrimin e statistikave shqiptare me standardet e BE-së.

Infrastruktura

TRANSPORTI

Infrastruktura rrugore mbetet prioriteti madhor i qeverisë në sektorin e transportit, siç pasqyrohet nga nivelet e larta të ndihmës së huaj të akorduara. Në 2008, janë rritur si financimi i brendshëm ashtu edhe ai i huaj që mbështesin projektet e mëdha rrugore. Projekti më i madh investues është rruga Durrës-Kukës-Morinë që pritet të përfundojë brenda vitit 2009. Së fundmi, është miratuar një plan veprimi për transformimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në një ent publik, konkretisht në Autoritetin Kombëtar të Rrugëve, ndërkohë që ligji përkatës është miratuar. Programi CARDS i KE-së e ka mbështetur këtë sipërmarrje bashkë me rishikimin e Masterplanit Kombëtar të Transportit i cili është baza e zhvillimit në të gjithë sektorin e transportit. Në transportin detar, progres është bërë në aspektin ligjor, ristrukturimin administrativ dhe investimet në porte. Transporti hekurudhor mbetet sektori më pak i zhvilluar dhe me më pak financime nga buxheti i shtetit.

Ndihma donatore për këtë sektor është rreth 492 milion EUR për 2000-2008, nga të cilat 81% janë hua tregtare dhe të buta dhe 18% grante. Donatorët kryesorë janë BERZH-i (25% ose 124 milion €), BEI (22% ose 110 milion €), Italia (14% ose 70 milion €) dhe Banka Botërore (13% ose 61.5 milion €).

Në 2008, totali i lëvrimëve nga ndihma e huaj ishte 271.5 milion €¹⁰, mbi dyfish krahasuar me vitet 2006 dhe 2007 (41.2 milion € në 2007 dhe 40.9 milion € në 2006)¹¹.

Përveç rrugës Durrës-Kukës që është financuar kryesisht nga buxheti i shtetit dhe huatë tregtare, projekti më i madh me financim të huaj me 50 milionë € nga BEI dhe 35 milionë € nga BERZH-i – është ndërtimi i rrugës Fier-Tepelenë.

Ndërtimi nga Italia i rrugës Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrja e punimeve në rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë kap vlerën 24 milion Euro në hua të buta. Deri në dhjetor 2008, janë arritur 97% e objektivave të projektit.

BEI po financon ndërtimin e Terminalit të Trageteve në portin e Durrësit me një vlerë prej 18 milion EUR. Projekti konsiston në: 1) ndërtimin e një terminali pasagjerësh dhe rehabilitimin e infrastrukturës përkatëse, dhe 2) vendosjen e elementeve të sigurisë për tragetet.

Për sa i përket zbatimit, rreth 17 projekte nuk kanë thujse fare lëvrim gjatë vitit 2008. Kjo shpjegohet me faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve apo autoritete të tjera, në disa raste edhe donatorët, kanë qenë më tepër ambiciozë seç duhet në ciklet e planifikimit të projekteve duke mos marrë parasysh vonesat administrative dhe procedurale si nga ana e qeverisë, ashtu edhe nga donatorët. Çështjet që kanë penguar ose ngadalësuar ritmin e zbatimit të projekteve me ndihmë të huaj, janë: vonesat në zgjidhjen e çështjes së shpronësimit ose mospërfshirja sa duhet e autoriteteve të pushtetit vendor, shpesh performanca e dobët e kontraktorëve të huaj, procedurat e ngadalta miratuese nga donatori dhe homologu shqiptar, cilësia e dobët e hartimit të projektit, etj. Pritet të ngrihet një agjenci kombëtare për burimet, të dhënat dhe informacionet për transportin, përditësimin e Planit Kombëtar të Transportit dhe investimeve që lidhen me të.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes GSP-së për transportin, për të cilin BB është pika fokale e donatorëve. Grupi për transportin është takuar rregullisht gjatë vitit 2008, ndonëse jo nën emrin e GSP-së. MPPTT ka luajtur një rol aktiv koordinues.

Sfidat kryesore të shprehura edhe nga donatorët për përmirësimin e nënsektorit të menaxhimit të rrugëve, janë: riklasifikimi i rrjeteve rrugore që të pasqyrojnë më mirë zotërimin dhe llogaridhënien në nivel qendror, rajonal dhe vendor; formulimin dhe zbatimin e Programeve gjithëpërfshirëse Kombëtare për Sigurinë e Trafikut; përmirësimi i lidhjes së rrjeteve kombëtare me ato ndërkombëtare; rritja e kapacitetit mbajtës të rrjetit rrugor, përfshi urat, që të mbajnë automjete më të rënda me ngarkesë më të madhe në bosht; përmirësimet cilësore dhe ristrukturimi i menaxhimit të rrugëve rurale.

¹⁰ Kjo shifër është marrë nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave dhe paraqet disbursimet për vitin 2008.

¹¹ Raporti për Transportin, MPPTT.

Nga ana tjetër, kapacitetet financiare vendore nuk mund të plotësojnë të vetme nevojat për investime në infrastrukturë dhe varësia nga transfertat prej pushtetit qendror pritet të vazhdojë për shumë bashki. Prandaj, marrëdhëniet ndërqeveritare duhet të bëhen më të parashikueshme dhe të shprehin incentiva që nxisin mobilizimin e të ardhurave vendore në mënyra që inkurajojnë efikasitetin ekonomik. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të krijohen incentiva që promovojnë nismat e partneritetit publik-privat për investime në infrastrukturën e transportit.


Në këtë kontekst, **prioritetet e ardhshme** për ndihmën e huaj përfshijnë: transformimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritet Kombëtar të Rrugëve dhe ripërcaktimin e funksioneve; përmirësimin e infrastrukturës rrugore; përmirësimin e menaxhimit të aseteve rrugore; përfundimin e rindërtimit të të gjitha akteve kombëtare me prioritet Tiranë-Shkodër dhe Durrës-Rrogzhinë; ngritjen e kapaciteteve për kontrollin e trafikut ajror; ngritjen e kapaciteteve për administratën detare sipas standardeve ndërkombëtare.

ENERGJETIKA

Sektori energjetik, si një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare, ka pasur investime në rritje gjatë viteve, të piketuara kryesisht për furnizimin me energji. Gjatë 2008-ës, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), nënshkroi me investues të huaj 50 kontrata koncesionare për ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentraleve. Gjatë tremujorit të fundit të 2008-ës, qeveria i dha një hua të drejtpërdrejtë KESH-it prej 25 milion EUR dhe vuri garanci 50 milion EUR për hua të ndryshme që KESH-i merr nga bankat shqiptare. Sipërmarrja më e rëndësishme gjatë 2008-ës ishte privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Gjithashtu, në qershor 2008, u miratua ligji për sektorin e gazit.

Sektori energjetik ka përfituar rreth 24% të gjithë mbështetjes donatore që i është dhënë Shqipërisë që në vitin 2000¹² që kap vlerën 561 milion EUR. Shumica e ndihmës i shkoi nënsektorit të energjisë elektrike për rehabilitimin dhe ristrukturimin, privatizimin e KESH-it, furnizimin me energji, ndërtimin e linjave të transmetimit, etj. Ndihma është dhënë kryesisht në formën e huave koncesionare (92% e ndihmës totale), çka është e përshtatshme për një sektor në proces shitjeje. Pesë donatorët më të mëdhenj në këtë sektor (BERZH, BEI, Banka Botërore, Gjermania dhe Italia), kanë kontribuar secili nga 14% deri në 21% të totalit të fondeve për periudhën 2000-2008.



Figura 1.24 Energjetika
Angazhimet dhe disbursimet gjithsej sipas donatorëve 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

12 EAOD 2008 Dokument I Orientimit të Ndihmës së Huaj

Produktet bazë të energjisë që kanë marrë ndihmë gjatë periudhës 2000-2008, janë: energjia elektrike, që përbën 65% të ndihmës totale dhënë këtij sektori, energjia hidrike, që përbën 16%, hidrokarburet që përbëjnë 14% dhe energjia e rinovueshme, që përbën 5% (shih grafikun poshtë).



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Së fundmi, mbështetja donatore për sektorin energjetik po zhvendoset drejt prodhimit të energjisë, përfshi financimin e termocentralit në Vlorë nga BEI, BERZH-i dhe BB-ja.

Zbatimi i ndihmës në këtë sektor ka qenë problematik, i karakterizuar nga lëvrime të ngadalta. Siç raportojnë donatorët, niveli total i lëvrimit ka qenë i ngadaltë, me normë minimale lëvrimi 54% për nënsektorin e energjisë hidrike. Në vitin 2008 ka pasur rënie të totalit të lëvrimeve krahasuar me 2007-ën, me përjashtim të ndihmës për energjinë e rinovueshme. Koordinimi i këtij sektori është bërë nëpërmjet Grupit Sektorial të Punës për Energjinë, për të cilin Banka Botërore është pikë fokale. GSP për energjinë është takuar rregullisht gjatë vitit 2008, pavarësisht se jo nën emrin e një GSP-je. METE ka luajtur rol aktiv bashkërendues.


Prioritetet e ardhshme në sektorin energjetik përfshijnë ndihmën për miratimin formal të Strategjisë Kombëtare për Energjinë, ngritjen e një kuadri institucional dhe rregullator efikas dhe ristrukturimin e plotë të shoqërive tregtare publike energjetike; rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme; investime të mëtejshme për përmirësimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe për mirëmbajtjen e digave.

MJEDISI


Ndërkohë që çështjet mjedisore po bëhen prioritet madhor i qeverisë, brenda sektorëve mund të përmendim këto arritje kryesore: ngritjen e kuadrit ligjor dhe institucional për financimin e karbonit; zgjerimin e sistemit të monitorimit mjedisor, punimet rehabilituese në rafinerinë e naftës në Ballsh; vlerësimin mjedisor dhe planin e veprimit në fushën e Patos-Marinzës; ndërtimin e një vendi groposjeje për mbetjet e rrezikshme në Tiranë, Fier, Rubik, etj; fillimin e fazës së dytë të projektit për asgjësimin e arsenikut në Fier.

KE, Banka Botërore, Holanda, Italia dhe Suedia janë pesë donatorët më të mëdhenj në këtë sektor, duke mbuluar 90% të ndihmës totale apo afërsisht 86 milion EUR nga një total prej 96 milion EUR të angazhuar për periudhën 2000-2008¹³. Nga ndihma totale për sektorin për periudhën 2000-2008, vetëm 39% është lëvruar deri në fund të 2008-ës. Shumica e financimeve janë në formë grantesh (72% ose 69 milion EUR) dhe shumë më pak si hua (28% ose 27 milion EUR).

Mbetjet inerte janë nësektori me mbështetjen më të lartë nga ndihma e huaj për periudhën 2000-2008 me 26% të të gjithë ndihmës, si edhe nësektori me performancën më të mirë për sa i përket normës së lëvrimit, konkretisht 43% e totalit të angazhuar është lëvruar gjatë 2000-2008. Nga ana tjetër, lëvrimi për nësektorin që përfshin vatrat e nxeha (hot-spots), peshkimin dhe pyjet, ka qenë i ngadaltë.



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Mbetjet inerte përfaqësojnë një nga problemet kryesore mjedisore në Shqipëri për shkak të shtimit të shpejtë të popullsisë, urbanizimit dhe bumit të ndërtimit, i cili e vë nën presion të madh sistemin e dobët të menaxhimit të mbetjeve. Kjo është arsyeja pse shumica e fondeve donatore për këtë sektor, përqendrohen te mbetjet inerte. Ndihma e huaj për nësektorët e tjerë përfshin asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit, monitorimin dhe vlerësimin, ngritjen e kapaciteteve për OJF-të mjedisore, etj.

Shqetësimi kryesor i donatorëve për sa i përket **zbatimit**, është se kapacitetet administrative në fushën e mjedisit, vazhdojnë të jenë të dobëta. Zbatimi i legjislacionit mjedisor vazhdon të jetë problematik dhe integrimi i politikave mjedisore në politikat e tjera është ende i pamjaftueshëm. Mbledhja e të dhënave mjedisore për qëllime monitorimi është e mangët dhe akoma e paorganizuar mirë. Këto janë disa arsye

kryesore që dëmtojnë zbatimin dhe normat e lëvrimit në këtë sektor.

¹³ Fondet e angazhuara sipas sektorëve janë për periudhën 2000-2008; cikli i jetës i projektit vazhdon deri në 2012.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes GSP-së së Mjedisit për të cilin Hollanda është pika fokale e donatorëve. Ky GSP është takuar dy herë gjatë vitit 2008 për të diskutuar mbështetjen e donatorëve për këtë sektor, strategjinë ndër-sektoriale dhe planin e saj të veprimit. GSP është takuar gjithashtu një here në vitin 2009 për të diskutuar problemet me menaxhimin e mbetjeve solide.

Prioritetet e ardhshme për ndihmën e huaj mbeten: mbështetja për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit komunitar, investimet për mbrojtjen mjedisore për të përmbushur standardet e Komunitetit Evropian brenda 20 viteve të ardhshme; menaxhimi i mbetjeve solide dhe ndërtimi i vend groposjeve të kontrolluara sipas standardeve të BE-së, si dhe përmirësimi i sistemit të monitorimit mjedisor.


FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Ndër zhvillimet më të rëndësishme në këtë sektor gjatë 2008-ës, ishte transferimi i ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në varësi të pushtetit vendor, si rezultat i reformës së decentralizimit dhe hedhjes në treg të këtij sektori. Investimet janë fokusuar në zonat turistike, zonat problematike urbane dhe ato rurale. Këto kanë çuar në përmirësimin e disa treguesve pozitivë si: rritja e numrit të konsumatorëve që janë të lidhur me sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, pakësimi i humbjeve të ujit, shtimi i orëve të furnizimit me ujë në shkallë vendi, rritje e arkëtimeve, ulje e kostove të drejtpërdrejta të mbuluara nga subvencionet.

Financimi i brendshëm dhe i huaj kanë qenë pothuaj në nivel të barabartë, por që së bashku shënuan rritje me të paktën 50% krahasuar me vitin e kaluar. Gjermania/KfW (Pogradec, Korçë, Kavajë, Berat, Kuçovë, Lushnjë, Elbasan) është donatori më i madh për këtë sektor, si në totalin e fondeve të angazhuara ashtu edhe në totalin e lëvruar (përkatësisht 26% dhe 41%), e ndjekur nga Japonia (Tiranë), vetëm në total fondesh të angazhuara (përkatësisht 23% dhe 0%), BEI (Sarandë, Lezhë, Fier, Durrës) 12% dhe 1%, Italia (Tiranë dhe Vlorë) 9% dhe 14%, KE (9% dhe 3%), Greqia (rrethi i Sarandës); Austria (qarku i Shkodrës), Zvicra (Shkodër, Pogradec); Norvegjia (Burrel); Luksemburgu (Dibër). Shumica e financimeve donatore për këtë sektor, janë në formë huash (62% ose 197 milion €), ndërsa 38% e fondeve janë grante (ose 120 milion €).

Figura 1.29 Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet

Angazhimet dhe disbursimet gjithsej sipas donatorëve, 2000-2008 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shqetësimet kryesore në lidhje me pakësimin e lëvrimin të projekteve me financim të huaj janë: cilësia e dobët e projekteve të hartuara; vonesat në miratimin e procedurave të ndryshme nga ana e donatorëve; bashkërendimi i dobët gjatë fazës së miratimit të procedurave dhe fazës së prokurimit. Në nëntor 2008, Grupi Sektorial i Punës për Ujësjellës-Kanalizimet mbajti takimin e parë. Takime periodike janë planifikuar për muajt në vijim. Austria, përmes Kooperacionit Austriak të Zhvillimit është pika fokale e donatorëve për këtë grup.

Për sa i përket financimeve të ardhshme, IPA 2007/2009 do të financojë ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve në zona problematike si Ura e Dajlanit-Qerret, Velipojë, Shirokë-Zogaj, Lezhë/Shëngjin, etj.

Pritet që varësia në financimet e huaja në planin afatgjatë dhe afatmesëm të rritet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve krahasuar me sektorë të tjerë. Kështu ndodh edhe në vendet candidate dhe anëtare të BE-së, ku një pjesë e mirë e fondeve të huaja dhe veçanërisht të BE-së, i kushtohen ujësjellës-kanalizimeve.

Prioritetet e ardhshme për ndihmë përfshijnë: investime në rrjetet e furnizimit me ujë në zona urbane dhe rurale; krijimi i një sistemi të kompjuterizuar faturimi dhe arkëtimi në ndërmarrjet e ujësjellësit; përfundimi i transformimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit në shoqëri tregtare; ngritja e Agjencisë Rurale për Ujësjellës-Kanalizimet; futja e një politike subvencioni për të inkurajuar ndërmarrjet për rikuperimin e kostove.

Zhvillimi social


ARSIMI

Reformat e qeverisë në sektorin e arsimit përfshijnë të gjitha nivelet, parashkollor, arsimin e mesëm dhe universitar. Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar u adoptua me vendim të KM-së në korrik 2009. Pjesa kryesore e reformës në arsimin parauniversitar konsistonte në shtimin e shkollimit të detyrueshëm nga 8 në 9 vjet dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet zbatimit të programeve të reja mësimore dhe monitorimit të tij. Qeveria është angazhuar të pajisë të gjitha shkollat me laboratorë informatike dhe internet brenda gjysmës së parë të vitit 2009. Cilësi dhe Barazi në Arsim si projekt kyç kontribuon në zbatimin e reformave në arsim, duke u fokusuar në reformat e kurrikulës, trajnimin e mësuesve dhe reformën e kualifikimeve, vlerësimin e menaxhimit të shkollave dhe liberalizimin e teksteve shkollore. Nga ana tjetër, decentralizimi, si pjesë kryesore e reformës, ka rritur pavarësinë administrative të Qendrave Rajonale Arsimore dhe autoritetin financiar të shkollave.

Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave në korrik 2008. Masat kryesore në vitet e fundit, bazuar në këtë strategji, janë fokusuar në zgjerimin e arsimit të lartë dhe përmirësimin e procedurave të pranimit, në përputhje me procesin e Bolonjës. Në vitin 2008 u ngrit Agjencia e Pranimit në Institucionet e Arsimit të Lartë. Gjithashtu, vitet e fundit janë hapur mjaft universitete dhe fakultete të reja, si publike ashtu edhe private, ndërkohë që janë zbatuar standardet për cilësinë dhe akreditimin. Fondi i Ekselencës mbuloi një numër të konsiderueshëm bursash për kërkime shkencore. Një zhvillim domethënës në lidhje me kërkimin akademik, ishte përfshirja e instituteve kërkimore të Akademisë Shqiptare të Shkencave brenda strukturës së instituteve të arsimit të lartë. Me vendim të Këshillit të Ministrave u miratua dhe Strategjia Ndërsëktoriale e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Kjo strategji është një tregues i angazhimit të qeverisë për të vënë edhe shkencën dhe kërkimin mes prioriteteve të tjera.

Reforma në arsimin dhe formimin profesional (AFP) u fokusua kryesisht në zhvillimet ligjore dhe institucionale. Ligji për AFP-në u ndryshua gjatë vitit 2008 dhe u hartua Kuadri Kombëtar për Kualifikimet Profesionale. Janë dhënë bursa në bazë të meritave për të stimuluar frekuentimin në shkollat e AFP-së.

Fondet donatore të angazhuara për periudhën 2000-2008 janë rreth 104 milion €, me normë lëvrimi 45% (ose 46.74 milion €). Në grafikun më poshtë janë dhënë donatorët kryesorë në këtë sektor, bashkë me lëvrimet përkatëse.




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Kontribute më të vogla janë dhënë edhe nga Kanadaja

Fushat kryesore të mbështetura nga ndihma e huaj kanë qenë ndërtimi dhe rehabilitimi i shkollave dhe bibliotekave; përmirësimi i cilësisë së nxënies; reformimi i arsimit të lartë dhe i AFP-së, etj.

Figura 1.31 Arsimi

Fondet e angazhuara vs. të Lëvruara sipas nënsektorëve, 2000-2008 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009.

Arsimi parashkollor me rreth 211,000 € (grante të gjitha) është nënsektori më pak i financuar, me vetëm tre donatorë: SHBA (rreth 0.85 milion €), Spanja (200,000 €) dhe Kanadaja (rreth 11,000 €). Mbështetja është fokusuar në programet e zhvillimit të për fëmijët e vegjël, ngritjen e kapaciteteve të shkollave fillore dhe stafit të kopshteve në Tiranë, krijimin e një qendre të kujdesit ditor në Tiranë, sigurimin e pajisjeve didaktike dhe pajisjeve të tjera.

Arsimi i mesëm ka përfituar pjesën më të madhe të ndihmës, me mbi 62 milion € nga të cilat rreth 49 milion € janë hua. Projektet në këtë sektor kryesisht mbështesin ndërtimin dhe rehabilitimin e shkollave dhe laboratorëve shkollorë, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit arsimor. Donatorët që mbështesin këtë nënsektor janë: Banka e Këshillit të Europës (26.4 milion €), BEI (12.5 milion €), Banka Botërore (rreth 10.25 milion €) bashkë me financimin e projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim, OKB-ja (3.68 milion €), Greqia (rreth 3.1 milion €), Italia (rreth 2.7 milion €), Spanja (rreth 1.86 milion €), Holanda

(rreth 1.6 milion €), Turqia (rreth 0.56 milion €) dhe Zvicra (rreth 0.13 milion €).

Arsimi i lartë ka përfituar afërsisht 16 milion € (grante të gjitha). Shumica e këtij fondi shkon për reformën në arsimin e lartë. Donatorët që mbështesin këtë nënsektor janë: KE-ja (rreth 9.2 milion €), Italia (4 milion €), Zvicra (rreth 1.2 milion €), Gjermania (1 milion €), Austria (0.3 milion €) dhe disa kontribute më modeste nga SHBA-ja, Spanja dhe Kanadaja.

Arsimi dhe formimi profesional ka përfituar afërsisht 24.6 milion € (grante të gjitha). Mbështetja donatore për këtë nënsektor është fokusuar në reformën e AFP-së, asistencë teknike dhe pajisje për të përmirësuar institucionet e AFP-së, rehabilitimin e godinave të shkollave, mbështetje teknike dhe institucionale, modernizim të arsimit turistik dhe ndihmë për forcimin e sistemit të punësimit dhe formimit profesional të Shërbimi Kombëtar të Punësimit. Donatorët kryesorë në këtë nënsektor janë: KE-ja (rreth 14.3 milion €), Zvicra (6.55 milion €), Gjermania (1.8 milion €), Italia (rreth 1 milion €), Austria (0.75 milion €) dhe SHBA-ja (rreth 0.25 milion €).

Arsimi është i vetmi sektor në Shqipëri ku zbatohet një Përqasje me Bazë Sektoriale (SWAp)¹⁴, e financuar bashkërisht mes Qeverisë dhe donatorëve, Projekti 'Cilësi dhe Barazi në Arsim' që ka filluar në tetor 2006. Projekti bazohet në Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar dhe financohet bashkërisht nga Qeveria shqiptare, Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës. Deri tani, zbatimi i projektit gjykohet si 'relativisht i kënaqshëm' dhe objektivi i tij është të arrijë nivelin 'i kënaqshëm'. Një nga implikimet e SWAp-it ishte eliminimi i disa Njësive të Zbatimit të Projekteve ekzistuese që merreshin me realizimin e projekteve të ndihmës së huaj. Zbatimi i metodës SWAp në arsim ka hasur në shumë vështirësi në këto aspekte: thithja e personelit me aftësi të larta, bashkërendim i brendshëm i mangët në MASH dhe brenda njësive zbatuese; supozimi i gabuar që kapacitetet e Menaxhimit Financiar janë funksionale (që Thesari i automatizuar dhe programi i kontabilitetit do të bëheshin funksionalë), nevoja për të ngritur kapacitetet prokuruese në Ministri dhe në nivelin e pushtetit vendor për të menaxhuar një gamë të gjerë procedurash voluminoze.

Që prej vitit 2007 Banka Botërore ka inkurajuar MASH të organizojë dy herë në vit mbledhje për rishikimin e reformave në sektorin e arsimit. Në këto mbledhje marrin pjesë të gjithë donatorët dhe mbështetësit financiarë të këtij sektori. Këto mbledhje janë një mekanizëm monitorimi për implementimin e Projektit 'Cilësi dhe Barazi në Arsim' për tre financuesit, BB, BEI dhe CEB. Por

14 SWAp13 – Qasje Mbarësektoriale

gjithmonë axhenda shkon përtej këtij projekti. Në të gjitha këto mbledhje janë të pranishëm dhe prezantojnë Ministri, zëvendës ministri, sekretari i përgjithshëm dhe gjithë manaxherët kryesorë të MASH. Ata ndërveprojnë me rreth 100 deri 150 të ftuar të cilët janë aktorët kryesorë në këtë sektor.

Një prej nën-grupeve të GSP, i krijuar në vitin 2008, është ai i fokusuar në çështjet e arsimit dhe trainimit profesional për të cilin Zvicra është pika fokale. GSP për arsimin dhe trainimin profesional u mblodh për herë të parë në korrik të vitit 2008. Tre mbledhje të këtij grupi janë planifikuar për vitin 2009.


Prioritetet e ardhshme në arsim përfshijnë mbështetjen për forcimin e kapaciteteve menaxhuese me qëllim përmirësimin e qeverisjes në institucionet arsimore të të gjitha niveleve, zbatimin e strategjisë së decentralizimit në arsim, ngritjen e EMIS-it (Sistemi i Informimit të Menaxhimit të Arsimit) funksional në të gjitha nivelet, ndërtimin dhe rehabilitimin e institucioneve arsimore, dhe mbështetjen e mëtejshme të qendrave AFP jashtë Tiranës.

SHËNDETËSIA

Bazuar në objektivat e projekt strategjisë për Sistemin e Kujdesit Shëndetësor, Qeveria ka ndërmarrë procesin e reformimit dhe modernizimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Baza e reformës është modernizimi i Kujdesit Shëndetësor Parësor nëpërmjet një burimi të vetëm financimi dhe autonomia e ofruesve të kujdesit shëndetësor. Ligji për kujdesin shëndetësor që përfshin financimin e spitaleve bazuar në skemën e sigurimeve shëndetësore të detyrueshme, u miratua nga Këshilli i Ministrave në 2008¹⁵. Gjithashtu, po mbështeten përpjekjet për konsolidimin e sistemit të emergjencave mjekësore. Ristrukturimi i sistemit spitalor është në proces; po përgatitet një plan racionalizimi/masterplan për sektorin e shëndetësisë përfshi sektorin privat, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti në sistemin spitalor. Sistemi HMIS (Sistemi i Informimit për Menaxhimin e Shëndetit) është gjithashtu nën zbatim.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara** për periudhën 2000-2008 brenda këtij sektori arrin afërsisht në 100 milion €, nga të cilat rreth 48.7 milion € (48.9%) janë lëvruar deri në fund të vitit 2008. Rreth 57% e mbështetjes për këtë sektor është në formën e granteve dhe 43% në hua. Përgjithësisht, grantet kanë normë më të lartë lëvrimit (rreth 56% të granteve të angazhuara) kundrejt huave (39% të huave të angazhuara).


Grafiku më poshtë paraqet donatorët që kanë mbështetur këtë sektor që në vitin 2000.



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009.

15 Aprovuar me vendim të Këshillit të Ministrave no 1715 dt 29.12.2008

Figura 1.33 Shëndetësia
Fondet e angazhuara vs. të Lëvruara sipas nënsektorëve,
2000-2008 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009.

Donatorët po japin mbështetje kryesisht në rindërtimin e spitaleve dhe qendrave të kujdesit shëndetësor parësor, sigurimin e pajisjeve mjekësore, planifikimin familjar, reformimin e qendrave spitalore, shëndetin parësor dhe një numër projektesh për shëndetin publik.

Kujdesi shëndetësor parësor ka përfituar rreth 23 milion EUR ku mbizotërojnë investimet. Donatorët kryesorë që mbështesin këtë nënsektor janë: Banka Botërore, Italia, SHBA-ja dhe Banka e Këshillit të Europës. Projekti më i madh është Modernizimi i Sistemit Shëndetësor, i Bankës Botërore në bashkëfinansim me Japoninë. Projekti mbështet përmirësimin e aksesit fizik dhe financiar në shërbimet e shëndetit parësor të cilësisë së lartë dhe përdorimin e këtyre shërbimeve.

Shëndeti dytësor ka përfituar mbështetjen më të madhe brenda sektorit me 50.5 milion EUR ose 51%. Projektet në këtë nënsektor u fokusuan në ndërtimin dhe riorganizimin e funksionimit të spitaleve.

Donatori më i madh në këtë sektor është Italia me 31.7%. Donatorë të tjerë janë Banka e Këshillit të Europës dhe Banka Islamike.

Shëndeti publik përfitoi rreth 15 milion EUR në grante. Donatorët që mbështesin këtë nënsektor janë Shtetet e Bashkuara me fokus kryesisht në shërbimet e planifikimit familjar, Italia, Spanja, Gjermania, Zvicra dhe Holanda.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes Forumit të Shëndetit (GSP për çështjet e shëndetit), për të cilin OBSH është pika fokale. Gjatë vitit 2008 forumi i shëndetit është takuar dy herë, respektivisht në mars dhe dhjetor 2008. Dy mbledhje të këtij GSP-je janë bërë gjatë vitit 2009, respektivisht në mars dhe qershor 2009.

Për **prioritetet e ardhshme**, në krye të listës qëndron përfshirja e shërbimeve spitalore nën skemën e sigurimeve shëndetësore. Prioritete të tjera kyçe janë: përmirësimi i funksionimit dhe qeverisjes së sistemit të kujdesit shëndetësor, krijimi i infrastrukturës së kualifikuar, përmirësimi i skemës së financimit të sistemit të kujdesit shëndetësor.


PUNËSIMI

Në vitet e fundit, treguesit e punësimit kanë ndjekur të njëjtën prirje përparimi si ekonomia shqiptare. Legjislacioni për promovimin e punësimit është përmirësuar dhe janë vënë në zbatim programe shtesë për promovimin e punësimit.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara** gjatë 2000-2008 është pak më tepër se 14 milion €, me normë mesatare lëvrimit 59% (rreth 8.25 milion €). Donatorët kryesorë që mbështesin këtë sektor janë Gjermania, KE-ja, Italia dhe Suedia (shih grafikun për detaje të mëtejshme).

Figura 1.34 Punësimi

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Donatorët po japin mbështetje kryesisht për modernizimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për Zyrat Rajonale të Punësimit në programin ‘Zhvillimi Ekonomik dhe Promovimi i Punësimit’, dhe janë fokusuar në forcimin e dialogut social, rritjen e ndikimit të remitancave të emigrantëve në Shqipëri në promovimin e punësimit, etj. Prioritet u është dhënë grupeve të pambrojtura si gratë në nevojë, të papunët mbi 50 vjeç, jetimët, romët, të rinjtë, të papunët prej një kohe të gjatë, etj. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është konsoliduar më tej nëpërmjet dixhitalizimit të sistemit (projekt pilot i financuar nga Suedia në Tiranë dhe Korçë), me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.


MBROJTJA SOCIALE DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Fokusi kryesor i politikave të mbrojtjes sociale është orientuar drejt uljes së varfërisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike, decentralizimit të mëtejshëm të shërbimeve sociale, transformimit të rezidencave sociale në shërbime për komunitetin, ofrimin e shërbimeve të reja sociale sipas nevojave të komunitetit dhe garantimin e cilësisë minimale për të gjitha shërbimet.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara** për këtë sektor gjatë 2000-2008 është rreth 19.6 milion €, me normë lëvrimi 78% (rreth 15.4 milion €). Pak më shumë se 65% (12.8 milion €) e fondit total është në grante, ndërsa huatë përbëjnë mbi 6.8 milion € të fondit total. Donatorët kryesorë në këtë sektor janë Banka Botërore, Italia, Mbretëria e Bashkuar, OKB-ja, të ndjekura nga shumë të tjera. Kontributet përkatëse janë dhënë në grafikun më poshtë.

Figura 1.35 Mbrojtja Sociale dhe Përfshirja Sociale

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Shënim: Kontribute më të vogla janë dhënë nga Turqia dhe Kanadaja

Donatorët po japin mbështetje kryesisht për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për forcimin e njerëzve të përjashtuar, për promovimin e integritimit të pakicave të pambrojtura duke fuqizuar Komunitetet e pambrojtura të Shqipërisë dhe duke mbështetur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kushtet e Jetesës të Romëve.

Mbështetja e ardhshme për këtë sektor fokusohet në mbështetjen e të Drejtave Evropiane të Romëve dhe të Qendrës Rajonale për të Drejtat e Romëve, si dhe në forcimin e shërbimeve që promovojnë integritimin social, kulturor dhe punësimin e të rinjve. Aktivitete të tjera të planifikuara fokusohen në mbrojtjen e fëmijëve shqiptarë viktimë të neglizhencës apo shfrytëzimit si dhe në linjën S.O.S. për ndihmë ndaj viktimave të trafikimit.

BARAZIA GJINORE DHE PARANDALIMI I DHUNËS NË FAMILJE


Në vitet e fundit, kuadri ligjor dhe strategjik për barazinë gjinore është përmirësuar, duke çuar në miratimin e ligjit për barazinë gjinore në vitin 2008. Ligji, nëpërmjet mekanizmave që vendosin kuota të përkohshme, parashikon barazi në përfaqësimin në parlament dhe në organet vendimmarrëse të të gjitha niveleve të qeverisjes.

Gjatë vitit 2008, plani i veprimit i Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës në Familje, u zgjerua më tej dhe u konsultua me donatorët e interesuar. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta po monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe ka përgatitur raportin e parë të progresit për 2008-ën. Për të garantuar zbatimin e plotë të strategjisë, u krijua edhe Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore që shërben si mekanizëm i ri institucional dhe organ konsultues.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara** për këtë sektor është afërsisht 9.58 milion € (grante të gjitha), me normë totale lëvrimi rreth 59% (rreth 5.6 milion €). Donatorët kryesorë në këtë sektor janë: Holanda (26%), Italia (25%), Suedia (18%), Austria (10%), Spanja (6%), OKB-ja (5%) dhe KE-ja (4%). Shifrat përkatëse janë paraqitur në grafikën më poshtë.

Figura 1.36 Barazia Gjinore dhe Parandalimi i Dhunës në Familje

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Gjatë viteve, mbështetja donatore është përqendruar në përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, promovimin e të drejtave dhe barazisë, fuqizimin e tyre me fokus të veçantë në zonat rurale, rritjen e rolit të gruas në qeverisje dhe pjesëmarrje në jetën politike, promovimin e sipërmarrjeve të grave, aksesin në drejtësi, etj. Mbështetja kryesore po jepet nëpërmjet një programi të përbashkët trevjeçar të agjencive të OKB-së për barazinë gjinore me kontributin e Hollandës. Si rezultat i këtij programi, pritet të përmirësohet reagimi i sektorit publik ndaj nevojave dhe prioriteteve të grave në nivel vendor; pritet të rritet pjesëmarrja e grave në proceset e llogaridhënies të cilat ndihmojnë në përparimin e barazisë gjinore; pritet të përmirësohet bashkërendimi i mbështetjes së huaj për qeverinë dhe shoqërinë civile në funksion të përparimit të barazisë gjinore.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes GSP për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës në Familje për të cilin UNIFEM është pika fokale. Gjatë vitit 2008 GSP zhvilloi dy mbledhje, respektivisht në janar dhe shtator 2008. Një mbledhje e këtij grupi u mbajt në mars 2009, ndërsa për pjesën tjetër të vitit janë planifikuar dy mbledhje të tjera.


RINIA, KULTURA DHE SPORTET

Prioritetet kyçe të politikave kulturore janë orientuar veçanërisht drejt promovimit të trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe rikonstruktimit të monumenteve kulturore, bashkë me përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet ndryshimeve në ligjin për Trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore. Disa nga arritjet në 2008 lidhen me restaurimin e monumenteve dhe objekteve të kultit si dhe ruajtjen e vlerave arkeologjike, siç ishte përfshirja e Beratit në trashëgiminë botërore të UNESCO-s, restaurimi i një sërë objektivsh kulturore në Gjirokastrë, etj. Prioritet ka qenë edhe zbatimi i ligjit për të drejtat e pronësisë intelektuale, duke synuar rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Gjithashtu u krijuan këto institucione: Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore; Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Përfaqësimi i të rinjve, të drejtat e tyre dhe sidomos pjesëmarrja në media u promovuan më tej nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të OJF-ve rinore me anë të trajnimeve të organizuara.

Totali i **mbështetjes donatore për kulturën** është rreth 13.13 milion € (grante të gjitha), të fokusuar kryesisht në trashëgiminë kulturore (përmirësimi i kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore, etj.), restaurimin e qendrave historike, mbështetjen me trajnim profesional për administratën shqiptare me synim mbrojtjen e monumenteve dhe artefakteve të lëvizshme. Norma e lëvrimit për këtë sektor është rreth 30% i totalit të fondeve të angazhuara. Donatorët kryesorë janë KE-ja (rreth 5 milion €), OKB-ja (rreth 4.26 milion €), Italia (1.25 milion €), Zvicra (rreth 1.2 milion €), Suedia (rreth 0.78 milion €), Austria (180,000 €), Greqia (157,900 €), Turqia (rreth 190,000 €) dhe disa kontribute modeste nga Japonia dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara. Spanja do të fillojë në vitin 2009 një program të gjerë Transformimi Kulturor: ‘Trashëgimia për Zhvillim Social dhe Ekonomik’ që do të zbatohet nga agjencitë e OKB-së.

Totali i **fondeve donatore të angazhuara për rininë** është rreth 2.6 milion € (grante të gjitha) me normë lëvrimi 45%. Donatorët po japin mbështetje kryesisht për të rritur pjesëmarrjen e rinisë në zgjedhje, duke rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e vendimmarrjes së përgjegjshme. Një tjetër fushë e mbështetur është Jetesa e Shëndetshme, arsimit dhe shërbimet për adoleshentët dhe të rinjtë. Në këtë sektor operojnë tre donatorë: OKB-ja (rreth 2 milion €), Suedia (rreth 0.63 milion €) dhe Kanadaja (rreth 7,700 €).

Grafiku më poshtë jep një panoramë të ndihmës donatore për kulturën dhe rininë.



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Prioritet e ardhshme për sektorin përfshijnë: ruajtje më e mirë, restaurim, mbrojtje dhe promovim i aseteve të trashëgimisë kulturore, duke zbatuar më mirë parimet e të drejtës së pronësisë intelektuale; promovimi më i mirë e aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore.


BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Politikat e zhvillimit rural mbështesin prodhimin bujqësor, blegtorinë, agro-industrinë dhe tregtimin e produkteve bujqësore; ato synojnë krijimin e mjedisit të duhur për shtimin e prodhimit dhe konkurrueshmërisë nëpërmjet modernizimit dhe përmirësimit të proceseve teknologjike. Progres është arritur në kapacitetet prodhuese dhe konkurrueshmërinë e sektorëve bujqësor dhe të agropërpunimit, të mbështetur nga kuadri ligjor i përmirësuar për të plotësuar standardet evropiane. Gjatë vitit 2008, janë zbatuar një numër skemash financiare në ndihmë të fermerëve, të financuara nga buxheti i brendshëm. Është arritur progres i mëtejshëm në përmirësimin e politikave kombëtare në lidhje me vaditjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytjet, reformimin e sistemit të menaxhimit të vaditjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet, në transferimin e përgjegjësive për vaditjen te shoqatat e përdoruesve të ujit.

Kontributi donator për këtë sektor gjatë 2000-2008 është pak mbi 162.54 milion €, me normë totale lëvrimi mbi 66% (rreth 108.2 milion €). Afërsisht 70% e kësaj ndihme është në formë grantesh dhe 30% janë hua.

Figura 1.38 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Donatorët kryesorë në këtë sektor janë KE-ja¹⁶, Italia, Banka Botërore, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, etj. (shih grafikun më poshtë për fondet e angazhuara dhe të lëvruara).

Në fokusin e donatorëve kanë qenë: (i) prodhimi, agropërpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore me afërsisht 48.6 milion €; (ii) siguria ushqimore¹⁷ me 23.8 milion € fonde totale të angazhuara; (iii) vaditja dhe kullimi me rreth 23.65 milion €; (iv) blegtoria me 4.83 milion €; dhe (v) zhvillimi rural me 55.13 milion €.

Dokumenti i Planifikimit Shumëvjeçar Indikativ (MIPD) 2009-2011 i KE/IPA-s, parashikon një fond për përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për mbështetjen e ardhshme që KE-ja do të japë në kuadrin e Komponentit III¹⁸ të IPA-s, përfshi mbështetjen për sistemet e informacionit.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes GSP-së për Bujqësinë dhe Ushqimin, Zhvillimin Rural

16 Një pjesë e madhe e fondeve të KE-së vijnë nga Programet Komunitare për Zhvillim që financojnë rrugët dytësore, etj.

17 Edhe Siguria Ushqimore është diskutuar në kuadrin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut; meqë lidhet nga ana institucionale me Ministrinë e Bujqësisë, është përfshirë në këtë seksion

18 Zhvillimi Rural

dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, grup për të cilin Banka Botërore është pika fokale. Ky grup ka pasur mbledhje të rregullta gjatë vitit 2008, respektivisht në janar, tetor dhe dhjetor 2008. Tre mbledhje të këtij grupi janë planifikuar për vitin 2009.

Një nga **prioritet e ardhshme** kryesore të strategjisë së zhvillimit rural, ishte ngritja e Agjencisë së Pagesave, institucioni financiar që do të merret kryesisht me fondet e IPARD-it. Ngritja e kësaj agjencie përfundoi në vitin 2008 dhe ngritja e kapaciteteve mbetet e hapur për bashkëpunim nga donatorët. Strategjia për bujqësinë identifikon prioritete të tjera strategjike që duhet të mbështeten nga ndihma e huaj, si: mbështetje për zhvillimin e strategjive për përdorimin e tokës dhe tregun e tokës; përmirësimi i menaxhimit të vaditjes dhe kullimit; përmirësimi i tregtimit të produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit; ngritja e qendrave për transferimin e teknologjisë bujqësore.

ZHVILLIMI RAJONAL

Gjatë vitit 2008, ligji për zhvillimin rajonal është hartuar dhe konsultuar me grupet e interesit në nivel vendor dhe qendror. Projektligji përcakton kuadrin statutor për krijimin e Programit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe për agjencitë e zhvillimit rajonal.

Ndihma e huaj për zhvillimin rajonal shpërndahehet përmes shumë agjencive qendrore, përfshi Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Ministrinë e Brendshme (MB), Ministrinë e Integritimit Evropian, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK). Nga 13 projekte që mbështesin këtë sektor, 5 janë në proces dhe 1 është i planifikuar.


Totali i fondeve donatore për këtë sektor gjatë 2000-2008 ka qenë rreth 19.7 milion €, me normë lëvrimi pak mbi 43% (8.6 milion €). Donatorët kryesorë janë OKB-ja (me shumë totale të angazhuar 5.87 milionë Euro), KE-ja (me 5.70 milionë Euro të angazhuara), Holanda (me 4.16 milionë), dhe Austria (me 4.02 milionë).

Një pjesë e madhe e mbështetjes ka shkuar për zhvillimin e zonave më të varfra në vend. Vlen të përmendet mbështetja e Hollandës për qarkun e Dibrës; mbështetja e qeverisë austriake për rrethin e Shkodrës dhe zonën informale të Kënetës në Durrës; mbështetja CARDS-it për zhvillimin e korridorit Tiranë-Durrës, si edhe mbështetja e dhënë nga OKB-ja për qarkun e Kukësit.

Një projekt i madh¹⁹ i bashkëfinancuar nga KE/CARDS dhe UNDP me rreth 5.2 milion €, pritet të fillojë në vitin 2009 dhe do të synojë plotësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave, si edhe ngritjen e agjencive të zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Projekti do të zbatohet nga UNDP-ja, duke konsoliduar përvojën e vet në Shqipëri për sa i përket zhvillimit të strategjive të ndryshme të zhvillimit rajonal.

Koordinimi në këtë sektor bëhet përmes Grupit Sektorial të Punës për decentralizimin dhe zhvillimin rajonal. GSP e fokusuar në problemet e zhvillimit rajonal është mbledhur dy herë, në prill dhe në shtator 2008. Takimet u fokusuan në progresin e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillimin Rajonal, në prioritetet e qeverisë dhe sfidat që paraqet zhvillimi rajonal, lidhjet me reformën e decentralizimit si dhe aktivitetet donatore në fushën e Zhvillimit Rajonal. Zvicra përmes Kooperacionit Zvicerian është pika fokale për këtë GSP.

Figura 1.39 Zhvillimi rajonal
Angazhimet kundrejt disbursimeve sipas donatorëve për 2000-2008 (në mln Euro)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

19 I quajtur 'Mbështetje e Integruar për Decentralizimin'.

Prioritetet e ardhshme përfshijnë mbështetjen për organizimin e qarqeve në Shqipëri sipas klasifikimit NUTS (Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat) që është përvojë e BE-së, si dhe forcimi i kapaciteteve të autoriteteve rajonale dhe vendore në menaxhimin e fondeve të BE-së në të ardhmen e afërt, sidomos kur duhen ndjekur praktikatat e BE-së në rastin e financimeve për zhvillimin rajonal në kuadrin e IPA-s. Investimet për përmirësimin e elementëve të infrastrukturës të qarqeve, mbeten vendimtare si për financimet e brendshme, ashtu edhe ato të huaja.

PLANIFIKIMI TERRITORIAL

Gjatë viteve 2007-2008, Shqipëria ka ndërmarrë një proces për përmirësimin e kuadrit ligjor të planifikimit territorial. Ky ligj synon të fusë planifikimin modern të orientuar nga tregu dhe një sistem për kontrollin e zhvillimit, të cilët do të lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të Shqipërisë.



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2009

Në lidhje me strehimin, një nga zhvillimet më të rëndësishme është miratimi i ligjit për administrimin e bashkëpronësisë në godinat e banimit. Gjithashtu, në kuadrin e angazhimit të Qeverisë për t'iu përkushtuar problemit të të pastrehëve, sipas llogaritjeve 6 000 familje kanë përfituar nga skema të ndryshme ndihme të hartuara për këtë qëllim.

Totali i fondeve donatore gjatë 2000-2008 është rreth 62.5 milion €, nga të cilat 6.4 milion € janë lëvruar (10.2%). Nga totali i angazhuar, 90% janë hua dhe vetëm 10% grante. Dy donatorët më të mëdhenj të këtij sektori janë Banka Qendrore Evropiane dhe Banka Botërore, që së bashku përbëjnë 90% të totalit të fondeve të angazhuara, të gjitha grante. Nga ana tjetër, Holanda dhe Suedia japin mbështetjen e tyre në formë granti.

Donatorët kanë dhënë asistencë teknike për formulimin e një kuadri modern të politikave të planifikimit të territorit. Pjesa më e madhe e mbështetjes është dhënë nga SHBA-ja dhe Banka Botërore. Zbatimi i këtij kuadri ende nuk ka

filluar, por pritet të mbështetet në të ardhmen nga projekti i Bankës Botërore 'Administrimi dhe Menaxhimi i Tokës', që do të mbështesë përgatitjen e planeve rregullore dhe planet e investimeve në infrastrukturë në 8 qytete të përcaktuara.

Në kuadër të programit MCC u parashikua Regjistri Kombëtar i Planifikimit. Objektivi i kësaj qendre është ngritja e një regjistri kombëtar elektronik për lejet e ndërtimit, duke ulur kështu mundësinë për korrupsion në sektorin e ndërtimit. Aktivitetet e planifikuara në këtë program janë: Regjistri Kombëtar i Planifikimit, një portal online për planifikimin dhe kodet e ndërtimit, udhëzimet, dhe njoftime, dizajnimin e programit të regjistrimit, krijimi i një baze të dhënash me informacion gjeografik, hartimi i legjislacionit dytësor të një sistemi trajnimit për Regjistrin Kombëtar të Planifikimit, zhvillimi i një plani trajnimesh për stafin e Regjistrin Kombëtar të Planifikimit mbi sistemi e ri të ndërtimeve.

Për sa i përket strehimit, projekti kryesor në këtë sektor mbështetet nga Banka e Këshillit të Europës, me synimin që familjeve në nevojë t'iu sigurohet strehim me kosto të ulët.

Grupi Sektorial i Punës për planifikimin territorial nuk ka qenë aktiv gjatë vitit 2008, por janë vënë re disa përmirësime gjatë fillimit të 2009-ës. Sapo të hyjë në fuqi kuadri i përgjithshëm i politikave, parashikohet se do të ketë nevojë thelbësore për ngritje kapacitetesh në nivel vendor. Përveç kësaj, është e nevojshme që projektet që janë në proces, të përshtaten brenda kuadrit të politikave të planifikimit që do të hyjë në fuqi.

TURIZMI

Politikat e turizmit për vitin 2008 janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës së zonave turistike dhe promovimin e potencialeve turistike²⁰ të Shqipërisë. Në vitin 2008, numri i turistëve të huaj u rrit me 21% krahasuar me vitin e mëparshëm dhe shumica e turistëve zgjedhën bregdetin si destinacion të preferuar. Strategjia Sektoriale për Turizmin e miratuar në qershor 2008 si dhe miratimi i kuadrit të ri ligjor për turizmin bashkë me ndryshimet e fundit, synojnë të përmirësojnë standardet e operatorëve turistikë.

Totali i fondeve donatore të angazhuara për këtë sektor është rreth 2.8 milion €. Megjithatë, deri në fund të 2008-ës nuk është regjistruar asnjë lëvrim i këtyre fondeve. KE-ja, nëpërmjet një fondi të IPA 2008, është angazhuar të mbështesë promovimin e turizmit në qarkun e Kukësit. Italia, nga ana tjetër, nëpërmjet dy projekteve është angazhuar të mbështesë forcimin institucional për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe promovimin e ekoturizmit në Përmet. SHBA-ja është angazhuar të mbështesë zhvillimin e një fshati turistik dhe OKB-ja gjithashtu ka një projekt që mbështet strategjinë për ekoturizmin në Shqipëri. Ka shumë projekte donatorësh që fokusohen në përmirësime të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve që priten të kenë impakt në zhvillimin e turizmit (këto projekte janë analizuar në kapitullin përkatës).

Prioritetet e ardhshme të mbështetjes donatore për këtë sektor përfshijnë: mbështetje për ndërgjegjësimin dhe marketingun; programe trajnimi profesional dhe institucione profesionale për menaxhimin e turizmit; mbështetje financiare për turizmin rural dhe format alternative të turizmit; ekspertizë dhe mbështetje teknike për zbatimin e projekteve pilot në komplekse turistike; dhe studime të standardizuara për zhvillimin e një tregu turistik që të jetë në përputhje me standardet e OBSH-së, EuroStat-it, OECD-së dhe Këshillit Botëror të Turizmit dhe Transportit (KBTT).

²⁰ Konkretisht, spoti publicitar në CNN, dy reklama rajonale në Kosovë dhe në Maqedoni dhe dy faqe zyrtare interneti për turizmin në Shqipëri.

Dialogu i politikave Qeveri-Donatorë

Zbatimi i Axhendës së Parisit

Një përjasje më e madhe e ndihmës së huaj me prioritetet strategjike dhe procesin e buxhetimit është një nga objektivat thelbësore të Sistemit të Planifikimit të Integruar të Qeverisë, i adaptuar si një set i principeve operuese për të siguruar që planifikimi dhe implementimi i politikave të qeverisë bëhen në një mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. Efektiviteti i menaxhimit të ndihmës së huaj ka qenë një shqetësim për qeverinë dhe donatorët që veprojnë në Shqipëri për vite me radhë dhe përpjekjet e tyre për të adresuar këtë shqetësim kanë kaluar përmes ciklesh të përmirësimeve të proceseve dhe arkitekturës institucionale.

Roli i Qeverisë në koordinimin e ndihmës së huaj ka ardhur në rritje që prej krijimit të DEBASKON në 2005. Roli qendror koordinues i DEBASKON është të sigurojë lidhje organike midis ndihmës së huaj dhe politikave kryesore dhe proceseve financiare të qeverisë. DEBASKON bashkëpunon shumë ngushtë me Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD).

STD u krijua në vitin 2003 duke pasur si objektiv lehtësimin e një dialogu qeveri-donatorë dhe dialogut mes vetë donatorëve. STD, fillimisht i përbërë nga katër donatorë shumëpalësh (KE, OSBE, PNUD dhe BB), në vitin 2008 u zgjerua me dy donatorë dypalësh (Gjermaninë dhe Hollandën), të cilat janë atëtare për vetëm një vit dhe më pas zëvendësohen nga donatorë të tjerë dypalësh. Austria dhe Zvicra do të jenë dy anëtarët dypalësh të STD duke filluar nga nëntori i vitit 2009.

Forcimi i mekanizmave koordinuese përmes Grupeve Sektoriale të Punës (GSP). Nga një numër total prej 30 Grupesh Sektoriale Pune, vetëm një numër i vogël janë takuar rregullisht gjatë vitit 2008 (kryesisht grupi për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, i Shëndetit, i Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje). Një numër i konsiderueshëm i këtyre grupeve ose nuk kanë organizuar asnjë takim, ose janë takuar në mënyrë sporadike. Gjatë gjashtë muajve të fundit theksi i është vënë kryesisht në operacionalizimin e mëtejshëm të GSP-ve funksionale dhe vitalizimin e GSP-ve të përgjumura. Kjo do të jetë thelbësore për një proces koherent të koordinimit dhe monitorimit të politikave në nivel sektorial. Synimi është që t'i jepet një rol aktiv GSP-ve në koordinimin e politikave dhe monitorimin e strategjive sektoriale, Programit të Buxhetit Afatmesëm dhe ndihmës së huaj. Gjithashtu GSP-të do të përdoren si forume për të diskutuar mundësitë për programe të përbashkëta mes qeverisë dhe donatorëve, forume në të cilat mund të identifikohen nevojat e institucioneve qeveritare dhe ku do të identifikohen potencialet sektoriale për të zbatuar Përjasjet me Bazë Programesh (PBP) apo Përjasjeve me Bazë Sektori (PBS).

“Arkitektura e Koordinimit të Donatorëve” në Shqipëri udhëhiqet nga Tryezat e Rrumbullakëta Qeveri-Donator. Këto tryeza të zyrtarëve të lartë të qeverisë dhe kryetarëve të misionëve të donatorëve adresojnë çështje strategjike të koordinimit, monitorojnë progresin e bërë drejt përmirësimit të efektivitetit të ndihmës së huaj dhe paraqesin një furum për dialogun qeveri-donatorë për çështje kritike. Në këto tryeza bëhet edhe një raportim i përpjekjeve koordinuese në sektorë.

Gjatë vitit 2008 u organizuan dy tryeza të rrumbullakëta. E para u organizua në maj 2008 dhe u fokusua në një çështje specifike siç ishte ajo e financimit nga ana e donatorëve për të zbutur impaktin e shpërthimit në Gërdec. Tryeza e dytë, u mbajt në nëntor 2008. Në këtë tryezë u bë një prezantim i progresit të bërë drejt integritimit në NATO dhe BE, zbatimit të SPI-së dhe rezultateve të Anketës së DAC për Monitorimin e Efektivitetit të Ndihmës së Huaj për vitin 2008. Në këtë tryezë u theksuan çështje të procesit të koordinimit të donatorëve dhe hapat e mëtejshme që duhen ndërmarrë për zbatimin e Deklaratës së Parisit për Efektivitetin e Ndihmës së Huaj dhe Axhendës për Veprim të Akrës. Kjo tryezë konkludoi me nevojën për të adoptuar një plan veprimi për harmonizim për të përmirësuar koordinimin e donatorëve dhe efektivitetin e ndihmës së huaj.

PLANI I VEPRIMIT PËR HARMONIZIM

Deklarata e Parisit ka përcaktuar 12 indikatorë dhe objektiva që duhet të arrihen deri në vitin 2010. Për arritjen e tyre, Qeveria dhe donatorët kanë bërë përpjekje të konsiderueshme të përbashkëta për të përmirësuar përdorimin e sistemeve të vendit dhe për ta bërë ndihmën më të parashikueshme nëpërmjet Përfaqësjeve me Bazë Sektoriale (PBS), dhe Përfaqësjeve me Bazë Programesh (PBP) dhe kuadreve të orientuara drejt rezultateve. Nevoja për të patur strategji të përbashkët dhe një Plan Veprimi për Harmonizim (PVH) me qëllim përmirësimin e koordinimit të donatorëve dhe efektivitetin e ndihmës së huaj doli në pah gjatë Tryezës së Rrumbullakët Qeveri-Donatorë në nëntor të vitit 2008. Në këtë takim u diskutua mundësia që komuniteti i donatorëve dhe Qeveria të thellojnë së bashku angazhimin në fushat kyçe të Axfordës për Veprim të Akrës dhe të shtojnë përpjekjet e përbashkëta për zbatimin e Deklaratës së Parisit. Për të përcaktuar fushat prioritare dhe për të parë progresin në këto fusha u ngrit një grup pune i përbërë nga donatorët (STD) dhe përfaqësues të qeverisë (DEBASKON dhe MF). Ky grup ka bashkëpunuar gjatë periudhës Janar-Qershor 2009 për hartimin e Planit të Veprimit për Harmonizim. Qëllimi i këtij dokumenti është të përmirësojë eficiencën dhe efektivitetin e menaxhimit të ndihmës së huaj duke u përqendruar në parimet e pronësisë së qeverisë, përshtatjes së ndihmës së huaj me prioritetet e qeverisë, përdorimit të sistemeve të vendit aty ku është e mundur dhe të harmonizimit dhe thjeshtimit të procedurave të vetë donatorëve. PVH nuk përqendrohet vetëm tek harmonizimi në kuptimin e ngushtë të adoptimit të procedurave dhe ndarjes së gjetjeve analitike mes donatorëve, por me vendosjen e një vargu masash që kanë të bëjnë me efektivitetin e ndihmës së huaj. Plani i Veprimit për harmonizim është specifik për çdo vend, por gjithmonë bazohet në pesë parime të partneritetit të përcaktuara në Deklaratën e Parisit: 'Pronësia', 'Pozicionimi', 'Harmonizimi', 'Menaxhimi për Rezultate', dhe 'Përgjegjësia e Përbashkët'. Përgatitja e planit po diskutohet midis partnerëve për zhvillim (të përfaqësuar nga STD) dhe qeverisë (DEBASKON) në lidhje me parimet dhe politikat të mirë përcaktuara që do të shërbejnë si bazë për hartimin e PVH-së dhe zbatimin të saj. Është kritike për efektshmërinë e PVH-it që qeveria bashkë me donatorët të angazhohen plotësisht mbi atë ç' ka bien dakord. PVH-ja do të përcaktojë objektivat e përbashkëta për qeverinë dhe donatorët për 12 indikatorët. PVH-ja do të jetë i lidhur me SPI-në për të formuar mekanizma të cilat gradualisht do të zvogëlojnë mundësinë për fragmentarizim midis donatorëve.

Promovimi i përdorimit të sistemeve kombëtare të prokurimit nga donatorët. Një nga arritjet e punës së përbashkët mes DEBASKON dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve në përgatitjen e Planit të Veprimit për Harmonizim lidhet edhe me prokurimet publike dhe aplikimin e metodologjisë së OECD/DAC për vlerësimin e cilësisë së tyre. Nevoja për një mundësi për të promovuar përdorimin e sistemeve kombëtare të prokurimeve nga donatorët duke u fokusuar fillimisht në vlerësimin e cilësisë së prokurimeve publike dhe në identifikimin e fushave që kanë nevojë për zhvillime të mëtejshme të kapaciteteve u konsiderua si një nga fushat e rëndësishme për përmirësim. Gjatë periudhës maj-qershor 2009 Metodologjia e Vlerësimit të OECD/DAC iu prezantua aktorëve kryesorë nga një mision nga Qendra për Zhvillimin e Kapaciteteve Prokuruese të Kombeve të Bashkuara (UN PCDC) me bazë në Kopenhagen. Qeveria dhe donatorët arritën në një konsensus të përbashkët për të implementuar këtë metodë vlerësimi dhe për ta përdorur këtë vlerësim si bazë për diskutimet me qëllim rritjen e përdorimit të sistemeve kombëtare të prokurimit, ashtu sikurse është rënë dakord në Deklaratën e Parisit dhe në Axfordën për Veprim të Akrës. Vlerësimi aktual është parashikuar të fillojë në nëntor dhe do të financohet nga PNUD. Qeveria dhe donatorët kanë rënë dakort që grupi që do të kryejë vlerësimin do të jetë një grup i përbashkët mes donatorëve dhe qeverisë, do të udhëhiqet nga qeveria dhe do të mbështetet nga konsulentë të huaj dhe partnerët për zhvillim (donatorët).

Konkluzioni i përbashkët mes qeverisë dhe donatorëve është që sistemet e prokurimeve publike në vend janë përmirësuar ndjeshëm pas vlerësimit të fundit, dhe të gjitha palët janë shprehur të interesuara për të bërë një vlerësim të ri me objektivin që të raportojë mbi indikatorët e Deklaratës së Parisit që lidhen me prokurimet publike; të identifikojë mangësitë në sistemin e prokurimeve publike dhe të zhvillojë një plan të bazuar në këtë vlerësim; dhe ta përdorë këtë vlerësim për të diskutuar mbi mundësinë e rritjes së përdorimit të sistemeve të prokurimeve në vend në përputhje me Deklaratën e Parisit dhe Axfordën për Veprim të Akrës.

shtojca 1. Grupet Sektoriale të Punës dhe Kalendari i takimeve

2008

Legjenda: U zhvillua planifikuar

Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	Nën-sektorët (sipas SKZHI-së)	2008											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Netor	Dhjetor
Mjedisi, Toka & Bujqësia	Bujqësia & Ushqimi, Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit	18/01									16/10		05/12
	Mjedisi								24/09				09/12
Infrastruktura & Energjetika	Energjia												
	Transporti												
	Uji										11/11		
	Planifikimi Hapësinor												
	E drejta e pronës								03/09 Vetëm donatorë		11/11 25/11		
Ekonomia & Financa	Biznesi & Investimet (Ekonomia)												
	Financat & Sigurimet Shoqërore												
Zhvillimi Social	Mbrojtja dhe përfshirja sociale												
	Barazia gjinore dhe dhuna në familje	24/01							16/09				
	Punësimi dhe Migracioni												
	Arsimi					16/05					05/10		
	AFP (Arsimi, formimi profesional)							11/07					
	Shëndetësia			12/03									09/12

Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	Nën-sektorët (sipas SKZHI-së)	2008											
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Drejtësia dhe Punët e Brendshme (Drejtësia, Rendi Publik, Krimi i Organizuar, MIK)	Reforma ligjore (Përfshin dy nëngrupe: Të drejtat e minoreneve & Reforma e Burgjeve (RB))		05/02 RB	20/03			26/06 RB	30/07				12/11 RL 25/11 RB	18/12
	Mbrojtja e dëshmitarëve							18/07					
	Krimi i Organizuar & Policia					22/05					24/10		
	Politikat komunitare/ Parandalimi i Krimin		27/02								16/10		
	Menaxhimi i Integruar i Kufijve						18/06						12/12
	Asistencë në trajnime & pajisje	24/01	22/02							04/09			
	Menaxhimi i Informacionit & Teknologjisë												
					Takimi Plenar 03/04								
Modernizimi i Qeverisë & Parlamenti	Administrata Publike							22/07					
	Statistikat												
	Teknologjia e Komunikimit & Informacionit											03/11	
	Anti-korrupsioni												
Decentralizimi & Zhvillimi Rajonal			20/03 Vetëm donatorë		14/05 Vetëm donatorë	09/06 Vetëm donatorë	31/07 Vetëm donatorë		22/09 RD		07/11 Dec		
Turizmi, Kultura & Rinia	Rinia												
	Kultura & Turizmi												
Shoqëria Civile & Media													
Zgjedhjet dhe Regjistri Civil													

shtojca 1. Grupet Sektoriale të Punës dhe Kalendari i takimeve

2008

Legjenda: U zhvillua planifikuar

N	Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	Nën-sektorët (sipas SKZHI-së)	2009												
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
1	Mjedisi, Toka & Bujqësia	Bujqësia & Ushqimi, Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit			J 4				J 4				J 4		
		Mjedisi			J 1				J 1				J 1		
2	Infrastruktura & Energjetika	Energjia										30/09			
		Transporti		J 4			J 4					J 4			
		Uji		J 2			J 2					J 2			
		Planifikimi Hapësinor											08/10		
		E drejta e pronës				J 4				J 4				J 4	
3	Ekonomia & Financa	Biznesi & Investimet (Ekonomia)		20/02 SME									15/10 SME		
		Financat & Sigurimet Shoqërore		J 4			J 4					J 4			
4	Zhvillimi Social	Mbrojtja dhe përfshirja sociale			J 2			J 2					J 2		
		Barazia gjinore dhe dhuna në familje			J 2								29/10		
		Punësimi dhe Migracioni			J 3			J 3					J 3		
		Arsimi					J 2						J 2		
		AFP (Arsimi, formimi profesional)		05/02				J 1				J 1			
		Shëndetësia			05/03				12/06					J 1	

N	Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	Nën-sektorët (sipas SKZHISË)	2009											
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
5	Drejtësia dhe Punët e Brendshme (Drejtësia, Rendi Publik, Krimi i Organizuar, MIK)	Reforma ligjore (Përfshin dy nëngrupe: Të drejtat e minoreneve & Reforma e Burgjeve (RB))	29/01			Takimi Plenar 28/04								
		Mbrojtja e dëshmitarëve	28/01											
		Krimi i Organizuar & Policia												
		Politikat komunitare/ Parandalimi i Krimet												
		Menaxhimi i Integruar i Kufijve												
		Asistencë në trajnime & pajisje	27/01											
		Menaxhimi i Informacionit & Teknologjisë												
6	Modernizimi i Qeverisë & Parlamenti	Administrata Publike				J 3			J 3				J 3	
		Statistikat		16/02			J 2				J 2			
		Teknologjia e Komunikimit & Informacionit						J 1					J 1	
		Anti-korrupsioni										15/10 Str. PP		
7	Decentralizimi & Zhvillimi Rajonal	Decentralizimi & Zhvillimi Rajonal (ZHR)		J 3			J 3				J 3			
8	Turizmi, Kultura & Rinia	Rinia			J 4			J 4				J 4		
		Kultura & Turizmi												
9	Shoqëria Civile & Media					J 2			J 2				J 2	
10	Zgjedhjet dhe Regjistri Civil					J 1			J 1				J 1	

DEPARTAMENTI I BASHKËRENDIMIT
TË STRATEGJIVE DHE KOORDINIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
KËSHILLI I MINISTRAVE

Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr.1 Tirana
Tel: + 355 4 2277 357
Fax: + 355 4 2226 354

koordinimi@km.gov.al
www.dsdc.gov.al